
Ndikimet e kornizës ligjore dhe praktikës së administratës publike tek barazia gjinore në elementët familjarë



Titulli i Projektit: *“Mbështetje për forcimin e kapaciteteve institucionale të KMD-së në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të promovuar parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit me lente gjinore”*

Ky studim u mundësua në kontekstin e Projektit: *“Zgjerimi i ndihmës ligjore falas për gratë dhe burrat në Shqipëri”*, **EFLAS**, i cili zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë dhe mbështetjen financiare të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC).

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë studim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim apo të donatorit të tij.

Ekspertët që punuan për studimin:

- Prof.Asoc.Dr. Ersida Teliti
- PhD Elvin Gjevori
- Kandidate PhD Diamanta Vito

Ndihmuan nga KMD:

- Klodiana Kamberaj
- Blerina Pirani
- Marsela Gjuzi

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	5
Hyrje	8
Metodologjia.....	12
Kufizime	15
I. Standardet ndërkombëtare	17
1. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Konventat themelore të Kombeve të Bashkuara	17
2. Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave	20
3. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës.....	24
4. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe parimet e Këshillit të Europës..	27
5. Jurisprudenca e GjEDNj në lidhje me mbiemrin e familjes dhe respektimin e barazisë gjinore në identitetin prindëror të fëmijëve	32
5.1 Çështja Ünal Tekeli kundër Turqisë (2004).....	33
5.2 Çështja Cusan dhe Fazzo kundër Italisë (2014)	35
5.3 Çështja León Madrid kundër Spanjës (2021).....	37
II. Analizë e legjislacionit shqiptar dhe praktika e administratës.	40
1. Në lidhje me mbiemrin.....	40
2. Gjetjet e pyetësorit për çështjet në lidhje me mbiemrin	45
3. Në lidhje me identifikimin e personit në aktet administrative.	47
4. Gjetjet e pyetësorit në lidhje me indentitetin e personit.....	48
5. Përmbledhje paraprake e gjetjeve	53
III. Mbi konceptin e Kryefamiljarit.....	55
1. Efektet ekonomike të përdorimit të konceptit të kryefamiljarit.....	57
2. Gjetjet nga pyetësoret për çështjen e kryefamiljarit	59
3. Përmbledhje paraprake e gjetjeve	60
IV. Përfundime dhe Rekomandime	62
1. Përfundime	62

2. Rekomandime.....	66
Bibliografi.....	69
Aneks 1	74
Aneks 2	76
Aneks 3	76
Aneks 4	78
Aneks 5	78
Aneks 6	79
Aneks 7	80
Aneks 8	84
Aneks 9	87
Aneks 10	92
Aneks 11	97
Aneks 12	98

Përmbledhje ekzekutive

Barazia gjinore është një nga përbërësit më thelbësorë të parimit të barazisë në tërësi si dhe një nga indikatorët më të fuqishëm të realizimit të barazisë efektive në shoqëri. Për rrjedhojë, edhe diskriminimi me bazë gjinore është një nga fenomenet më negative duke reflektuar pasojat në çdo fushë të jetës. Në të gjitha shoqëritë, ky diskriminim ndodh kundrejt grave dhe vajzave dhe një nga arsyet kryesore lidhet me traditat dhe zakonet si dhe reflektimi i tyre në aktet normative dhe në veprimtarinë e administratës publike.

Duke qenë se familja është formacioni kryesor shoqëror ku ndodhin marrëdhënie të përditshme dhe zhvillohet jeta midis burrit dhe gruas, është me rëndësi të kuptohen pabarazitë brenda saj si dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e personalitetit të fëmijëve. Në këtë kuptim, rezulton se pozicioni i burrit në familjen shqiptare është akoma në një pozitë superioriteti kundrejt gruas.

Kështu, rezulton që në 2.4% të familjeve shqiptare kryefamiljarja është grua, duke përfshirë edhe familjet ku gruaja është kryefamiljare e vetme. Ndërsa, vetëm në 0.41% të familjeve që i kanë të dy bashkëshortët, kryefamiljarja është grua. Procesi i vendosjes së kryefamiljarit nuk ka një rregullim dhe vendosja bëhet nga veprimet e administratës së gjendjes civile, duke lënë në këtë mënyrë një ndikim të gjerë të traditës patriarkale në këtë përcaktim.

Sipas gjetjeve të studimit, vetëm në 2.84% të totalit të familjeve shqiptare, mbiemri i përbashkët i familjes është ai i gruas. Ndërsa, numri i familjeve ku bashkëshortët kanë mbajtur secili mbiemrin e vet para martesë është 10.67 % e totalit të familjeve. Ndër këto, vetëm në 2% të familjeve ku bashkëshortët kanë mbajtur mbiemrat e tyre para martesë, mbiemri i fëmijëve ka qenë ai i nënës. Në këto raste pabarazia gjenerohet nga dispozitat e Kodit të Familjes, por edhe nga mungesa e informimit si dhe një rregullimi të qartë të veprimeve të administratës së gjendjes civile.

Edhe në identifikimin e personit në veprime të ndryshme administrative rezulton që gjerësisht të kërkohet vendosja e atësisë. Në përgjigje të pyetësorëve mbi 60 % e punonjësve të administrative të ndryshme pohojnë se kërkojnë atësinë e personit në veprimet administrative, ndërsa rreth 25% e tyre pohojnë se e kërkojnë atë herë pas here. Gjithashtu, 55% e punonjësve pohojnë se vendosja e atësisë kërkohet nga aktet normative, por edhe kur nuk parashikohet në akte nënligjore 45% pohojnë se e

kërkojnë si pasojë e praktikës së punës. Vetëm në 20 % të ankëtuarve pohojnë se ndonjëherë kërkojnë edhe amësinë.

Vendosja e atësisë predominon edhe në aktet administrative të ndryshme, mbi 55 %, si dhe në të gjitha dokumentat dhe certifikatat që kanë lidhje me arsimin.

Në tërësi studimi gjen se identiteti prindëror i personave në përgjithësi dhe fëmijëve në veçanti nuk rezulton i trajtuar në mënyrë të barabartë në aspektin gjinor. Kjo për shkak të praktikës së mbiemrit dhe mos reflektimit të mëmësisë në dokumentat e ndryshëm administrative ku kërkohet identiteti i personit nga organet publike, ose të vendosjes së vetëm atësisë në këto dokumenta.

Si rezultat i këtyre gjetjeve është e dukshme predominanca e burrit në identitetin e familjes dhe të fëmijëve, si dhe zhdukja e identitetit të gruas duke mos u reflektuar tek fëmijët. Kjo, jo vetëm që vendos gruan në një situatë të pabarabartë dhe diskriminuese në familje, por ndikon edhe në një zhvillim jo të plotë të personalitetit të fëmijëve. Ky reflektim jo proporcional i identiteve prindërore tek fëmijët, ushqen pabarazinë gjinore si një normalitet brenda në familje, duke mbajtur fort stereotipet mbi rolet gjinore dhe vendosjen e burrit si Kryetar de jure dhe de facto. Kjo situatë është njëkohësisht produkt i mendësisë patriarkale dhe akteve normative që duke ushqyer njëra tjetrën krijojnë një rreth vicioz.

Përveç fotografimit të situatës në lidhje me implikimet gjinore të akteve ligjore dhe nën-ligjore që rregullojnë identitetin e fëmijëve, gjetjet e këtij studimi synojnë që të mundësojnë edhe një diskutim më të gjerë mbi rolet gjinore në familje, barazinë efektive midis gjinive në familje dhe reflektimin e këtij botë-kuptimi në aktet ligjore dhe praktikën administrative.

Në përgjigje të një rregullimi të kësaj pabarazie si dhe të përshtatjes së situatës së Shqipërisë me standardet ndërkombëtare të OKB dhe KiE, studimi jep dhe disa rekomandime që kanë për synim rregullimin e akteve normative por edhe të ndryshimit të praktikës së administratës, duke marrë parasysh edhe gjetjet e jurisprudencës së GjEDNj-së.

Lista e shkurtimeve:

OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
DUDNJ	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
PNDPCP	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
PNDESHK	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore
KEGJFDG	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KDF	Konventa mbi të drejtat e fëmijës
RP	Rekomandim i Përgjithshëm
KP	Koment i përgjithshëm
KEDG	Komiteti për eliminimin e diskriminimit ndaj gruas
KDNJ	Komiteti për të drejtat e njeriut
KEDNj	Konventa Europiane për të drejtat e njeriut
GjEDNj	Gjykata Europiane për të drejtat e njeriut
KiE	Këshilli i Europës
KSH	Kushtetututa e Shqipërisë
KC	Kodi civil
KF	Kodi i familjes
RKGjC	Regjistri kombëtar i gjendjes civile
LBGJ	Ligji Nr.9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”
LMD	Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.

Hyrje

Trajtimi i barabartë para ligjit është çështje thelbësore e sundimit të ligjit. Kur flasim për sundimin e ligjit - si prioritet themelor i funksionimit të një shoqërie demokratike që përqëndrimin kryesor e ka në respektimin e të drejtave të njeriut - kuptojmë, ndër të tjera, dhe një barazi efektive të gjinive. Kësisoj, barazia mes grave dhe burrave përbën një të drejtë themelore dhe një vlerë thelbësore për demokracinë. Në mënyrë që kjo të arrihet realisht, barazia mes grave dhe burrave duhet jo vetëm të njihet ligjërisht, por të zbatohet me efikasitet në të gjitha aspektet e jetës politike, ekonomike, sociale dhe kulturore.¹

Republika e Shqipërisë ka ratifikuar një sërë Konventash për mbrojtjen nga diskriminimi gjinor dhe promovimin e barazisë midis burrit dhe gruas. Këto akte ndërkombëtare jo vetëm që janë të detyrueshme për zbatim nga shteti shqiptar dhe janë të vendosura hierarkisht lartë në piramidën e akteve normative, por përbëjnë dhe një udhëzues kuptimi të të drejtave themelore të njeriut si për parashikimet kushtetuese ashtu edhe për veprimtarinë e të gjitha organeve publike. Për një kuptim më të gjallë të këtyre Konventave dhe për zbatimin e tyre në frymën që ato mëkojnë, ndihmon puna e Komiteteve të ndryshme mbikqyrëse nëpërmjet rekomandimeve të tyre dhe Gjykatave nëpërmjet vendimeve të tyre.

Në nenin 18 të Kushtetutës së Shqipërisë parashikohet parimi i barazisë formale dhe thelbësore, duke përcaktuar ndër të tjera që askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe të tilla si gjinia dhe përkatësia prindërore, si dhe duke përcaktuar që diferencime mund të ketë por vetëm nëse ato janë objektive dhe kanë një përligjje të arsyeshme. Në përputhje me Kushtetutën dhe konventat janë miratuar edhe ligje të rëndësishme si Kodi i Familjes (Ligj Nr.9062, datë 8.5.2003, i ndryshuar), Ligji Nr. 10 129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar (Ligji për Gjendjen Civile), Ligji Nr.9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri” (LBGJ) dhe Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar (LMD).

Në bazë dhe në zbatim të këtyre ligjeve ndërtohen edhe akte administrative të cilat synojnë të paraqesin përbërjen e gjendjes familjare në bazë identiteti, gjinie dhe marrëdhënie familjare, duke pasur gjithmonë parasysh parimin e barazisë por edhe atë të interesit më të lartë të fëmijës. Në këtë kuptim, nga aspekti i të

¹ “Barazia Gjinore dhe Diskriminimi në Organet e Emëruara të Pushtetit Vendor”, Raport monitorimi i kryer nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në bashkëpunim me UN Women Shqipëri, Tiranë, 2019.

<https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/05/Barazia-gjinore-dhe-diskriminimi-ne-organet-e-meruara-te-pushtetit-vendor.pdf>

drejtës publike, është detyrë e Shtetit që të rregullojë çështjet e identitetit të personave kryesisht për arsye të sigurisë dhe interesit publik si dhe të rregullimit të të drejtës familjare. Nga ana tjetër, nga aspekti i të drejtës private, këto rregullime që Shteti bën duhet të balancohen dhe të jenë në respekt të dinjitetit të njeriut, të lirisë dhe identitetit të personit si dhe të parimit të barazisë.²

Pavarësisht kuadrit ligjor në fuqi, diskriminimi ndaj grave shpesh fshihet pas traditave që janë kthyer në zakone që më pas marrin formën juridike të rregullave të shkruara ose të pashkruara. Një nga format më të përhapura të diskriminimit ndaj grave konsiston në mohimin e nënkuptuar, nga shumica e sistemeve ligjore kombëtare, të të drejtës për t'ua kaluar mbiemrin fëmijëve të tyre. Shumica e shteteve, parashikojnë atribimin automatik të mbiemrit atëror për të sapolindurit që janë ngjizur gjatë martesës së prindërve të tyre ose që janë njohur nga babai i tyre.³

Kjo praktikë jo vetëm që diskriminon gratë si nëna, por diskriminon edhe gratë si vajza pasi shpesh shkakton një preferencë të papranuar të prindërve, dhe veçanërisht të babait, për fëmijët meshkuj. Arsyeja e kësaj preference qëndron kryesisht në cilësinë e djalit për të përjetësuar mbiemrin e babait. Atribimi automatik i mbiemrit atëror shpesh lidhet me nevojën për të ruajtur unitetin e njësisë familjare. Në fakt, ky argument duket se është dobësuar për shkak të krizës që ka pësuar martesa me rritjen e numrit të zgjidhjeve martesore.⁴

Shtete të ndryshme kanë gjetur zgjidhje të ndryshme për të garantuar barazinë mes burrit dhe gruas në çështjen e përcaktimit të mbiemrit të pasardhësve të tyre si edhe për të pasur një regjim më pak diskriminues ndaj grave. Lidhur me këtë çështje, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka një praktikë të konsoliduar e cila i njeh të drejtën grave për t'i dhënë fëmijëve mbiemrin e tyre.

Në Shqipëri gjithashtu është shënuar progres në zbatimin e ligjeve e standardeve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes të të drejtave të njeriut. Në këtë kuptim, edhe mënyra e trajtimit dhe mbrojtjes dhe trajtimi i barabartë i gjinive është

² Për një panoramë të gjerë mbi të drejtën familjare në Shqipëri dhe aspektet ligjore, referohen:

Aleks Luarasi "Marrëdhëniet Familjare" Botim i SHB Luarasi, Tiranë 2001

Arta Mandro "E drejta Familjare" SHB Emal, ShB Emal, Tiranë 2009

³ Fabbricotti. A (2017), "Il diritto al cognome materno. Profili di diritto civile italiano, di diritto internazionale, dell'Unione europea, comparato ed internazionale private".

https://www.academia.edu/31880354/Il_diritto_al_cognome_materno_Profili_di_diritto_civile_italiano_di_diritto_internazionale_dell_Unione_europea_comparato_ed_internazionale_privato

⁴ Po aty.

rregulluar me një qasje tjetër, duke krijuar bazë të veçantë ligjore.⁵ Për sa i përket caktimit të mbiemrit të bashkëshortëve të ardhshëm dhe i pasardhësve të tyre rregullohet nga dispozitat e Kodit të Familjes. Sipas përcaktimeve të Kodit, ata kanë të drejtë të zgjedhin për të mbajtur si mbiemër të përbashkët njërin nga mbiemrat e tyre ose të mbajnë secili mbiemrin e vet. Ndërsa për fëmijët, Kodi parashikon se ai merr mbiemrin e përbashkët të prindërve. Kur prindërit kanë mbiemra të ndryshëm, të gjithë fëmijët mbajnë një mbiemër, atë që do të vendosin prindërit me marrëveshje. Gjithësesi, në rast se marrëveshja mes prindërve nuk arrihet, fëmijët mbajnë mbiemrin e të atit.

Për gjithë sa më sipër, duhet mbajtur parasysh jo vetëm karakteri identitar i rregullimeve ligjore, por edhe fakti që në bazë të këtyre rregullimeve janë projektuar dhe krijuar një sërë aktesh të tjera ligjore dhe nënligjore që shërbejnë si bazë për përfitimin e shumë pagesave me karakter social si ndihma ekonomike, pensione të ndryshme, rimbursime apo dhe pagesa për aftësinë e kufizuar, etj.

Në lidhje me këtë të fundit, nisur nga studimi *“Mbrojtja e përmirësuar e konsumatorëve në nevojë kundër diskriminimit përmes forcimit të zbatimit të kornizës përkatëse ligjore dhe rregullatore”*⁶ (ndryshe, Studimi për Klientin në Nevojë), u evidentua se disa pagesa të rëndësishme me karakter social në lidhje me rimbursimin e energjisë elektrike⁷ lidheshin me konceptin e Kryefamiljarit.⁸ Gjithashtu, edhe në bazë të rekomandimit të KMD nr.1080.prot. datë 21/07/2022 drejtuar Këshillit të Ministrave për rishikimin e akteve nënligjore përkatëse, u evidentuan problematika kufizuese që lidheshin me konceptin e Kryefamiljarit dhe u rekomandua, *“përcaktimi i përfitimit të kompensimit të diferencës së çmimit të energjisë elektrike, nëse njëri nga bashkëshortët është me aftësi të kufizuar, pavarësisht nëse është kryefamiljar apo jo”*.

⁵ Mbi aspekte më të gjera në lidhje me barazinë gjinore, referohet: A.Mandro, A.Anastasi, E.Shkurti, A.Bozo “Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi”, SHB Dajti, Tiranë, 2011.

⁶ Studimi është kryer nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në bashkëpunim me disa organizata të shoqërisë civile si dhe me mbështetjen e PNUD Shqipëri dhe Ambasadës Norvegjeze:<https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/04/Studim-Klienti-ne-nevoje.pdf>

⁷ VKM nr. 565, datë 09.08.2006 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar; VKM nr. 8, datë 14.01.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 KWH”; VENDIMNr.404, datë 20.6.2012 “Për përcaktimin e masës së kritereve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse” (ndryshuar me VKM nr. 616, datë 22.9.2022).

⁸ Një ndër rekomandimet e këtij studimi në lidhje me argumentin ishte: *“...shkëputja e përfitimit të kompensimeve të parashikuara nga VKM-të në fuqi nga koncepti i Kryefamiljarit”*.

Në bazë të hetimit të kryer për adresimin e këtij Rekomandimi, u evidentua ndër të tjera se vetëm 2.41%⁹ të familjeve shqiptare kishin kryefamiljare grua në certifikatën familjare. Gjithashtu, referuar VKM Nr. 882, datë 24.12.2019 “Për mekanizmin e bashkërendimit ndërinstucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike”, në lidhje me përfitimin e ndihmës ekonomike (NE), «familjet që përfitojnë NE dominohen nga kryefamiljarë meshkuj» dhe «kryefamiljaret femra përbëjnë 10% të familjeve me përfitim të përgjithshëm».¹⁰

Në legjislacionin shqiptar Kryefamiljari nuk gëzon në vetevete një përkufizim ligjor. Ky koncept *de facto* përkon me atë të Kryetarit të Familjes, i cili mbart në vetvete aspekte të traditës patriarkale ku figurë qendrore në familje është ajo e burrit dhe gjendet i parashkuar në akte ligjore të mëparshme. Për shembull, në Kodin Civil të Mbretnisë Shqiptare, viti 1929, Neni 188 parashikonte që «burrit asht kreu i familjes: gruaja ndjek pozitën civile të burrit, merr mbiemrin e tij, dhe detyrohet me e shoqënuë kudo që ai e sheh të arsyeshme me caktue qëndresën e vet».

Në parashikimet e sotme ligjore kjo traditë patriarkale, e cila reflektohet edhe në aktet e gjendjes civile si dhe në akte të tjera nënligjore, apo edhe disa akte ligjore, krijon kontradiktë me parimin e barazisë dhe me Kodin e Familjes, pasi sipas këtij ligji “...martesa, si një bashkëjetesë ligjore, mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve...”. Nga aspekti gjinor, rezulton se vetëm në një pjesë shumë të vogël të familjeve shqiptare Kryefamiljar në kuptim të certifikatës familjare është gruaja, në rreth 0.41 % të familjeve që i kanë të dy bashkëshortët.

Ky kufizim gjinor në praktikë shkakton jo vetëm pengesa në përfitimin e pagesave sociale por është edhe një indikator i rëndësishëm në pabarazinë gjinore midis burrave dhe grave në aktet e gjendjes civile, që dëshmon mbi prevalencën e rolit të burrit në familje pavarësisht frymës së barazisë që përshkon aktet ligjore.

Bazuar në rëndësinë dhe zhvillimin e vazhdueshëm të shumë prej nocioneve dhe të drejtave të përmendura më sipër, ky studim synon të analizojë nëse aktet ligjore, nënligjore dhe administrative që rregullojnë parimin e barazisë dhe pozicionin e gruas në gjendjen familjare, si dhe identitetin personal të fëmijëve, janë rregulluar në bazë të parimit të barazisë.

⁹ Kjo përqindje përfshin edhe familjet me kryefamiljare të vetme.

¹⁰ Kjo përqindje përfshin edhe familjet me kryefamiljare të vetme.

Më specifikisht, në këtë studim do të analizohet me vëmendje aspekti i mbiemrit në kuadrin e identitetit të personit në lidhje me përkatësinë e nënës, identifikimi i personit nëpërmjet atësisë, si dhe implikimet gjinore të konceptit të kryefamiljarit, duke pasur në vëmendje jo vetëm parashikimet normative por edhe ndikimin e faktorëve social-kulturorë në praktikën e administratës.

Metodologjia

Ky studim synon jo vetëm të hedhë dritë mbi mënyrën se si aktet rregullatore reflektojnë, përforcojnë dhe në disa raste formësojnë normat shoqërore përsa i përket identitetit gjinor dhe identitetit personal të fëmijëve por edhe të orientojë debatin publik mbi këto tema, sidomos në lidhje me ndërhyje dhe përmirësime të mundshme ligjore. Kësisoj ky studim mund të kategorizohet si *kërkim i aplikuar* i cili synimin kryesor e ka të formësojë politikë-bërjen dhe në tërësi diskursin publik mbi temën që trajton. Duke qenë që nuk ka shumë studime të tjera mbi këtë temë në Shqipëri, studimi bazohet mbi një qasje holistike duke ofruar një panoramë të zhvillimeve në rang ndërkombëtar, rregullimin ligjor të këtyre temave në Shqipëri, praktikën administrative dhe në fund edhe mënyrën se si administrata i kupton dhe trajton këto tema në zbatim të normave përkatëse.

Për të arritur sa më sipër studimi bazohet në një qasje të kombinuar të analizave cilësore dhe sasiore.¹¹ Ky kombinim është bërë gjithmonë e më i përhapur në studimet e shkencave sociale pasi mundëson ofrimin e të dhënave numerike, deri diku më objektive, dhe analizën e thelluar të këtyre të dhënave për të mundësuar identifikimin e mekanizmave shkakësorë që shpjegojnë fenomenet e identifikuar.¹²

¹¹Bennett, Andrew and Colin Elman. 2006. "Qualitative Research: Recent Developments in Case Study Methods." *Annual Review of Political Science*, 9: 455-476.

Hay, Colin. 2006. "Political Ontology." In Goodin and Charles Tilly (Ed.s.), *The Oxford Handbook of Contextual Political Analysis*. Oxford University Press: Oxford, UK. 78- 96.

¹²Stinchcombe, Arthur. 1968. *Constructing Social Theories*. University of Chicago Press: Chicago, Ill.

Amenta, Edwin and Kelly Ramsey. 2010. "Institutional Theory." In Leicht and J. Craig Jenkins (Ed.s.), *Handbook of Politics: State and Society in Global Perspective*. Springer: New York, NY. 15-39.

Fentress, James and Chris Wickham. 1992. *Social Memory*. Blackwell: Oxford, UK.

Hacking, Ian. 1999. *The Social Construction of What?* Harvard University Press: Cambridge, UK.

Specifikisht, në këtë studim analiza cilësore u bazua në një shqyrtim të kujdesshëm të akteve ligjore e nënligjore përkatëse, si dhe aktet dhe standartet ndërkombëtare. Kështu, janë analizuar Konventa të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, Rekomandime të përgjithshme të komiteteve mbikqyrëse, jurisprudencë e GjEDNj-së, legjislacioni shqiptar si dhe akte nënligjore të ndryshme.

Gjithashtu, për të siguruar një njohje paraprake të situatës aktuale, rastet dhe nivelin e diskriminimit gjinor, bazuar në përcaktimin e kryefamiljarit me gjininë mashkullore, në shërbime të targetuara u krye dhe një hulumtim e analizë e raporteve dhe studimeve të kryera më parë. E gjithë kjo analizë shërben për t'i ofruar lexuesit një panoramë të qartë të standarteve ndërkombëtare dhe realitetit shqiptar si instrument për të mundësuar krahasimin.

Përveç sa më sipër, vlera e shtuar e studimit – nga këndvështrimi i përfuturit të të dhënave parësore të reja – bazohet mbi zhvillimin e dy pyetësorëve dhe intervistave të thelluara respektivisht me punonjës të zyrave të gjendjes civile në rang vendi dhe me punonjës të administratës të institucioneve të ndryshme që ofrojnë shërbime kryesisht sociale në Korçë, Vlorë, Fier, Shkodër, Durrës dhe Tiranë.

Dy pyetësorët e zhvilluar dhe shpërndarë ishin si vijon:

1. Pyetësor për njohjen e praktikës të administratës së gjendjes civile në lidhje me procedurat për përcaktimin e kryefamiljarit dhe të mbiemrit të fëmijëve.
2. Pyetësor për mbledhjen e të dhënave në lidhje me identitetin gjinor prindëror të personave në administratën publike.

Pyetësori i parë u ndërtua në mënyrë specifike për zyrat e GJC dhe kishte 21 pyetje. Qëllimi i këtij pyetësori është të evidentojë praktikën e administratës së gjendjes civile në lidhje me konceptin e kryefamiljarit dhe përcaktimin e tij/saj në certifikatën familjare si dhe me përcaktimin e mbiemrit të fëmijëve në rastet kur bashkëshortët kanë mbiemra të ndryshëm, për të kuptuar implikimet gjinore dhe respektimin e parimit të barazisë midis burrit dhe gruas.


Pyetësori i dytë është i ndërtuar në mënyrë specifike për punonjësit e institucioneve qëndrore dhe drejtoritë e tyre rajonale si INSTAT, ALEAT, NJMF, Universitete, Ndihma Juridike Falas, QKB, Qendra Kulturore, ZVAP, Drejtoritë e Përgjithshme të Transportit Rrugor, Drejtoritë Vendore të Policisë, Sektorët e Dhunës në Familje, Qendrat Komunitare, , OSHEE, UKT, Posta, Sigurimet

Shoqërore, Drejtoritë e Strehimit, AKU, Operatori i shërbimeve të kujdesit shëndetësor, Bashkitë dhe përmban 19 pyetje.

Pyetësorët u hartuan dhe testuan në periudhën Dhjetor 2022 Janar –2023. Pas finalizimit të pyetësorëve ato i janë shpërndarë grupeve të targetuara. Pyetësorët drejtuar Gj.C janë shpërndarë dhe plotësuar në rrugë elektronike. Pyetësi për identitetin gjinor prindëror është plotësuar në kontakt të drejtëpërdrejtë me të gjithë të anketuarit, duke kryer dhe intervista të shkurtra për qartësimin e të dhënave ose për informacione shtesë të pa përfshira në pyetësor. Pas përfundimit të këtij procesi është vijuar me përpunimin e të dhënave nëpërmjet programit statistikor SPSS 17.


Drejtoria e përgjithshme e gjëndjes civile ka dhënë një mbështetje të konsiderueshme për plotësimin e pyetësorëve i cili u realizua në rrugë elektronike.

1. Pyetësi 1 plotësuar nga Gj.Civile – total 242.



Nga ana e tyre janë plotësuar të dy pyetësorët, me një total prej 566 për të dy pyetësorët. Në pyetësin e dedikuar për gjëndjen civile janë përfshirë 182 gra rreth 75% dhe 60 burra pra 25%, pra 242 punonjës total përgjigjur.

2. Pyetësi 2 plotësuar nga institucionet – 1133 total.



Pyetësi i dytë drejtuar institucioneve të tjera që ofrojnë shërbime të ndryshme u plotësua drejtpërdrejt nga rreth 1133 pjesëmarrës (punonjës) në qarqet e targetuara, nga të cilët 261 ishin burra, 859 gra, 1 punonjës ka përcaktuar tjetër

dhe 12 të tjerë sjanë përgjigjur për këtë pyetje. Nga ana e gjëndjes civile për pyetëtorin e dytë janë përgjigjur 324 punonjës nga të cilët 87 burra dhe 237 gra.

Në tërësi, vihet re një dominancë e grave në punë ndërsa, për marrjen e shërbimeve vihet re dominancë e burrave.

Të dhënat e gjeneruara nga këto pyetësorë, mundësuan hartografimin e plotë të mënyrës së ofrimit të shërbimeve dhe zbatimit të akteve rregullatore nga administrata në lidhje me identitetin gjinor dhe atë personal të fëmijëve. Analiza e të dhënave të përfituara mundëson identifikimin e mekanizmave shkakësorë si ligjore dhe sociale, veprimet administrative dhe interpretimet e administratës ndaj këtyre akteve, që mund të nxisin pabarazinë midis burrit dhe gruas.

Kufizime

Si çdo studim tjetër edhe ky ka kufizimet e veta.¹³ Siç u shprehëm edhe më sipër ky është një studim i aplikuar i cili ka si synim dhe audiencë politikë-bërësit dhe drejtuesit e administratës publike.

Një kufizim i parë lidhet me evidentimin e faktit që rekomandimet e Komiteteve mbikëqyrëse të Konventave si dhe Raportet Periodike për Shqipërinë nuk gjenden në gjuhën shqipe, por kanë gjithmonë nevojë për një përkthim sporadik dhe parcial i cili shpesh mund të mos jetë në kuptimin e duhur, për të cilin hulumtuesit punuan me variantet në gjuhë të huaj .

Kufizimi i dytë është fokusi në praktikën dhe botëkuptimin e punonjësve të administratës që ofrojnë shërbime të caktuara. Edhe pse ato janë përgjithësisht përfaqësues të karakteristikave të shoqërisë shqiptare në tërësi, përgjithësimi i të dhënave nuk mund të shkojë përtej punonjësve të administratës. Ndoshta në të ardhmen do të ishte me shumë interes që ky studim t'i targetohej edhe popullsisë që merr shërbimet mbështetëse të administratës në nivel qëndror apo vendor.

Përsa i përket pyetësorëve, ne jemi të vetëdijshëm se në disa raste ato plotësohen edhe pa i kushtuar shumë vëmendje pasi ngarkesa e punonjësve të administratës është e qenësishme. Në tërësi ky është një rrezik dhe kufizim i metodës së

¹³ McKeown, Timothy. 2004. "Case Studies and the Limits of the Quantitative Worldview." In Brady and David Collier (Ed.s.), *Rethinking Social Inquiry: Diverse Tools, Shared Standards*. Rowman and Littlefield Publishers: London, UK. 139-167

pyetësorëve. Gjithësesi në rastin e këtij studimi, ky kufizim u adresua duke patur një numër shumë të lartë pyetësorësh të plotësuar si dhe duke zhvilluar intervista me personat që plotësuan pyetësorët.

Së fundmi, u vu re mungesa në informacion të përgjithshëm, ose më saktë interpretime të ndryshme për të njëjtat procedura, gjë e cila në disa raste sjell konfuzion në analizim dhe përpunim të dhënash, sidomos për disa procedura të cilat duhet të jenë të unifikuara në të gjitha degët e institucionit.

I. Standardet ndërkombëtare

1. *Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Konventat themelore të Kombeve të Bashkuara.*

Standartet e Kombeve të Bashkuara në lidhje me të drejtat e njeriut mishërohen në Konventat e ndryshme të gjeneruara ndër vite duke filluar me Deklaratën Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) e duke pasuar me Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP)¹⁴, Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (PNDESHK)¹⁵, Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEGJFDG)¹⁶, Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës (KDF)¹⁷. Qëllimi i tyre ideal është që ti bëjë të drejtat e njeriut universale, ndërsa qëllimi i tyre praktik është që të përfshihen në rendet juridike të vendeve të ndryshme duke i vendosur këto standarte si parime udhëheqëse në bazë të çdo Kushtetute, norme ligjore dhe veprimtarie institucionale. Pranimi dhe ratifikimi i Konventave të të Drejtave tregon një vullnet dhe qasje pozitive të shteteve që marrin impenjimin kombëtar dhe ndërkombëtar që ti respektojnë, ti mbrojnë dhe ti promovojnë të drejtat e njeriut.

Shqipëria është një nga ato vende që i ka ratifikuar të gjitha Konventat themelore të Kombeve të Bashkuara që me hapjen e saj drejt shtetit demokratik.

Për qëllim të studimit tonë është pikërisht nga këto Konventa që do të nxjerrim parimet dhe të drejtat themelore të njeriut të cilat në pjesën më të madhe janë njohur dhe përbëjnë një përpjekje të vazhdueshme për respektimin dhe mbrojtjen e tyre. Fokusi kryesor do të jetë parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit, sidomos në lidhje me aspektin gjinor. Në fakt të dy këto parime përshkojnë Deklaratën Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) në tërësinë e saj dhe vendosen si në preambul ashtu edhe në dispozita konkrete.

Që në paragrafin e parë të deklaratës barazia e dinjitetit të të gjithë njerëzve vendoset si vlerë themelore e «familjes njerëzore»¹⁸ dhe në vazhdim specifikisht, barazia midis burrave dhe grave vendoset si vlerë bazë bashkë me patjetërsueshmërinë e të drejtave dhe vlerën e njeriut. Në nenin 1 DUDNJ «të

¹⁴ Ratifikuar me Ligj Nr.7510 datë 08.08.1991.

¹⁵ Ratifikuar me Ligj Nr.7511 datë 08.08.1991.

¹⁶ Ratifikuar me Ligj Nr.7767 datë, 09.11.1993.

¹⁷ Ratifikuar me Ligj Nr. 7531, datë 11.12.1991.

¹⁸ Në të njejtën mënyrë barazia vendoset si parim themelor edhe në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike si dhe Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.

gjithë njerëzit linden të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta» dhe në nenin 7 DUDNJ «të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabar nga ligji».

Edhe në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, parimi i barazisë vendoset si vlerë themelore në kuptim të përgjithshëm por edhe duke vënë theksin në barazinë gjinore. Kështu, në nenin 26 PNDCP «*të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë mbrojtjeje të barabartë të ligjit pa kurrfarë dallimi»*, si dhe «*ligji duhet të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë për të gjithë, mbrojtje të barabartë dhe efektive, kundër çdo diskriminimi e sidomos për shkak të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionit politik dhe çdo opinionit tjetër, origjinës kombëtare apo shoqërore, pasurisë, lindjes ose çdo shtate tjetër»*. Në nenin 3 të PNDCP vëmendje të veçantë i kushtohet barazisë gjinore dhe sipas këtij neni, «*Shtetet palë të këtij Pakti zotohen të sigurojnë të drejtën e barabartë të burrit dhe të gruas lidhur me gëzimin e të gjitha të drejtave civile dhe politike të përcaktuara në këtë Pakt»*.¹⁹

Në kartat themelore të OKB-së aspekti gjinor merr një kuptim të veçantë dhe ndërthuret përherë me të drejtën e familjes. Kështu, që në Deklaratën Universale shtetet njohin që burrat dhe gratë kanë të drejtë të lidhin martesë dhe të krijojnë familje, duke e njohur këtë të fundit si «*bërthama e natyrshme dhe themelore e shoqërisë»*.²⁰ Gjithashtu, ato gëzojnë të drejta të barabarta «*si në rastin e lidhjes së martesës, gjatë martesës si dhe në rast shkurorëzimi»*. I njëjti parashikim rimerret në nenin 23 të PNDCP duke shtuar që, «*në rastet e prishjes së martesës, do të merren masa me qëllim që fëmijëve t'u sigurohet mbrojtja e nevojshme»*,²¹ si dhe në nenin 10 PNDESHK duke specifikuar që familjes duhet ti garantohet «*një mbrojtje dhe ndihmë sa më e gjerë ... sidomos për formimin e saj dhe për aq kohë sa ajo ka përgjegjësinë për mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve në ngarkim»*.

¹⁹ Të njëjtin parashikim bën dhe neni 3 PNDESHK sipas të cilit, Shtetet palë të këtij Pakti zotohen të sigurojnë të drejtën e barabartë të burrit dhe të gruas për t'i gëzuar të gjitha të drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore të përmendura në këtë Pakt.

²⁰ Neni 16 DUDNJ – 1. *Burrat dhe gratë në moshë madhore kanë të drejtë të lidhin martesë dhe formojnë familje, pa kurrfarë kufizimi për sa i përket racës, shtetësisë ose besimit. Ata kanë të drejta të barabarta si në rastin e lidhjes së martesës, gjatë martesës si dhe në rast shkurorëzimi.*

2. *Martesa duhet të lidhet vetëm me pëlqimin plotësisht të lirë të personave që do të martohen.*
3. *Familja është bërthama e natyrshme dhe themelore e shoqërisë dhe ka të drejtën e mbrojtjes nga shoqëria dhe shteti.*

²¹ Neni 23/4 PNDCP - *Shtetet palë të këtij Pakti marrin masa të përshtatshme për të siguruar barazinë e të drejtave dhe të përgjegjësisë të bashkëshortëve lidhur me martesën, gjatë martesës dhe me rastin e prishjes së saj. Në rastet e prishjes së martesës, do të merren masa me qëllim që fëmijëve t'u sigurohet mbrojtja e nevojshme.*

Në lidhje me nenin 23 PNDPC dhe barazinë midis bashkëshortëve, Komiteti për të Drejtat e Njeriut (KDNJ) në Komentin e Përgjithshëm nr.19 paragrafi 7, parashikon që në kuptim të parimit të barazisë «*duhet të ruhet e drejta e secilit nga bashkëshortët për të mbajtur përdorimin e mbiemrit të tij ose të saj origjinal, ose për të marrë pjesë në baza të barabarta në zgjedhjen e një mbiemri të ri*».

Në lidhje me fëmijët, në vazhden e kujdesit dhe ndihmës së posaçme që kërkon Deklarata Universale,²² si dhe krahas të drejtës për familje,²³ për arsim,²⁴ për shtetësi,²⁵ për zhvillim të shëndetshëm²⁶ dhe zhvillim të personalitetit të tij/saj,²⁷ parashikohet edhe e drejta për çdo fëmijë për të pasur një identitet. Neni 24 PNDPC parashikon marrjen e masave specifike mbrojtëse që duhet të garantohen nga familja, shoqëria dhe shteti dhe në paragrafin 2 të këtij neni parashikohet shprehimisht si e drejtë themelore lidhur direkt me identitetin dhe personalitetin ligjor, e drejta e çdo fëmije që «*të regjistrohet menjëherë pas lindjes dhe të ketë një emër*».²⁸

Siç vërehet nga një analizë e dispozitave të Konvetave themelore, barazia gjinore midis burrit dhe gruas, e drejta për familje dhe të drejtat në familje, si dhe qëllimi i kësaj të fundit për të krijuar fëmijë, për ti mbrojtuar ato dhe për ti garantuar zhvillimin e personalitetit të tyre, lidhen ngushtësisht dhe kërkojnë marrjen e masave konkrete dhe efektive nga ana e shteteve palë, për garantimin maksimal të tyre.

Duke pasur parasysh që me gjithë rëndësinë e këtyre parashikimeve, është e nevojshme për më shumë impenjime konkrete si dhe më shumë garanci efektive në lidhje me barazinë gjinore dhe të drejtat e fëmijëve, Organizata e Kombeve të Bashkuara gjeneron edhe dy Konventa shumë të rëndësishme, të cilat janë të

²² Neni 25/2 DUDNJ - *Nënat dhe fëmijët kanë nevojë për kujdes dhe ndihmë të posaçme. Të gjithë fëmijët, të lindur brenda ose jashtë martese, gëzojnë të njëjtat mbrojtje sociale.*

²³ Neni 25 DUDNJ, neni 23 PNDPC, nenet 10,11 PNDESHK.

²⁴ Neni 26 DUDNJ, neni 18 PNDPC, neni 13 PNDESHK.

²⁵ Neni 24 PNDPC,

²⁶ Neni 12/2/a PNDESHK.

²⁷ Nenet 22, 26 DUDNJ, neni 13 PNDESHK.

²⁸ Sipas Komisionit për të Drejtat e Njeriut (KDNJ) në Komentin e Përgjithshëm (KP) Nr.17, ky parashikim është projektuar për të promovuar njohjen e personalitetit ligjor të fëmijës. Gjithashtu, kjo dispozitë duhet interpretuar e lidhur ngushtë me dispozitat e tjera të Paktit që lidhen me masat e posaçme për mbrojtjen e fëmijës (neni 23/4 dhe neni 24/1). Po sipas këtij Komenti e drejta për një emër merr rëndësi të veçantë sidomos për fëmijët e lindur jashtë martese, ndërsa regjistrimi shikohet si masë mbrojtëse kundër për të ulur rreziqet e rrëmbimit, shitjes apo trafikimit të fëmijëve.

dedikuara për dy kategori që kanë nevojë për mbrotje të veçantë si dhe garanci më shumë për barazi thelbësore e mosdiskriminim: fëmijët dhe gratë.

2. Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave

Edhe pse Deklarata Universale dhe paktet themeltare i kushtojnë një rëndësi të veçantë parimit të barazisë e sidomos të barazisë midis burrit dhe gruas, është vënë re me shqetësim «*se me gjithë këto instrumente të ndryshme, vazhdon të ekzistojë një diskriminim i madh ndaj grave*», sidomos në rastet e grave në kushtet e varfërisë.²⁹ Gjithashtu, vërejtja e diskriminimit me bazë gjinore dhe mos garantimit të barazisë midis burrave dhe grave, shtrihet në të gjitha fushat e jetës, politike, ekonomike, juridike, shoqërore e kulturore, por një vetëdije e veçantë i kushtohet edhe nevojës për «*një ndryshim të rolit tradicional të burrit dhe të gruas në familje dhe në shoqëri për t'u arritur barazi e plotë midis burrit dhe gruas*».³⁰

Për të inkurajuar barazinë gjinore si dhe luftuar çdo formë të mundshme diskriminimi kundrejt grave Asambleja e Kombeve të Bashkuara me Rezolutën e saj 34/180 të datës 18 dhjetor 1979, miraton Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave. Kjo konventë përbën themelin e vetëdijes së shteteve mbi diskriminimin ndaj grave³¹ dhe vendos impenjime dhe detyrime konkrete për:

(a)³² përfshirjen në kushtetutat e tyre kombëtare ose në ndonjë dispozitë tjetër ligjore të përshtatshme, parimin e barazisë së burrit dhe të gruas, po qe se ende nuk është bërë, dhe të sigurojnë nëpërmjet legjislacionit dhe masave të tjera të përshtatshme zbatimin praktik të këtij parimi;

(b) miratimin e masave ligjore dhe masave të tjera të përshtatshme duke përfshirë edhe sanksione, po qe se është e nevojshme, duke ndaluar çdo formë të diskriminimit ndaj grave;

(c) vendosjen e një mbrotje gjyqësore të të drejtave të grave, mbi bazën e barabartë me burrat, dhe sigurimin, nëpërmjet gjykatave kombëtare kompetente

²⁹ Preambula e KEGJDFG.

³⁰ Po aty.

³¹ Sipas Konventës diskriminimi ndaj grave nënkupton «*çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet mbi bazën e seksit, e që ka për pasojë ose për qëllim të komprometojë ose të asgjësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, pavarësisht nga gjendja e tyre martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër*».

³² Listimi do të bëhet sipas mënyrës së përkthimit në shqip të Konventës.

dhe institucioneve të tjera publike, të mbrojtjes efektive të grave kundër çdo veprimi diskriminues;

(ç) mos ndërmarrjen e asnjë veprimi ose praktike diskriminuese ndaj grave dhe sigurinë që autoritetet dhe institucionet publike të veprojnë në përputhje me këtë detyrim;

(d) marrjen e të gjitha masave të përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave që ushtron ndonjë person, organizatë ose çfarëdo ndërmarrje;

(dh) marrjen e të gjitha masave të përshtatshme, duke përfshirë legjislacionin, për të ndryshuar ose shfuqizuar ligjet ekzistuese, rregulloret, zakonet apo praktikatat të cilat përbëjnë diskriminimin ndaj gruas;

(e) shfuqizimin e të gjitha dispozitave të brendshme penale të cilat përbëjnë diskriminimin ndaj gruas.³³

Krahas mbrojtjes së shumë të drejtave themelore të gruas si çdo qenie njerëzore si ndalimi i trafikimit dhe shfrytëzimit të prostitucionit (Neni 6), të drejtës së barabartë për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur dhe pjesëmarrjes së grave në çdo aspekt të jetës politike, publike dhe të vendimmarrjes (Nenet 7-8), të drejtës për kushte të barabarta në arsim (Neni 10), të drejtave të barabarta në punësim dhe marrjen e masave të veçanta (Neni 11), të drejtës për shëndet (Neni 12), të drejtat në fushat e tjera sociale dhe ekonomike (Neni 13), të drejtave të grave në zonat rurale (Neni 14), të drejtave të barabarta civile, pronësore, gjyqsore (Neni 15), si dhe marrjes së masave të përkohëshme të veçanta për të luftuar pabarazitë *de facto* (Neni 4), Konventa bën dhe parashikime të rëndësishme në lidhje me personalitetin e gruas, të drejtat martesore si dhe rolin e saj në familje.

Së pari, në nenin 5 të Konventës kërkohet marrja e masave të përshtatshme «*për të ndryshuar karakteristikat dhe modelet sociale e kulturore të sjelljes së burrit dhe të gruas, në mënyrë që të arrijnë të zhdikin paragjykimet dhe praktikatat zakonore, dhe të gjitha praktikatat e tjera që mbështeten në idenë e inferioritetit ose të superioritetit të njërit apo të tjetrit seks, ose në rolet stereotipe të burrit dhe të gruas*».³⁴ Në këtë kuptim, Konventa shkon përtej aspektit të të drejtës

³³ Neni 2 i Konventës përcakton natyrën e të gjitha detyrimeve të shteteve palë dhe është kyç për implementimin e plotë të Konventës. Për një kuptim të qartë të nenit 2 dhe të vetë Konventës KEGJFDG ka miratuar Rekomandimin e Përgjithshëm nr.28, për të cilin ndër të tjera shtetet palë kanë dhe detyrimin ta përkthejnë në gjuhët e tyre kombëtare.

³⁴ Në lidhje me këtë dispozitë Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Gruas (KEDG), në RP nr.28 sugjeron që duhet parë dhe interpretuar së bashku me nenin 2 para.dh) në kuptimin social dhe kulturor të identiteteve dhe roleve për gratë dhe burrat të ndërtuara nga shoqëria në bazë të dallimeve biologjike, rezultati i të cilave vendos një marrëdhënie hierarkike midis grave dhe burrave në shpërndarjen e pushtetit dhe të drejtave duke favorizuar burrat dhe disavantazuar gratë.

ndërkombëtare dhe asaj ligjore të shteteve, duke njohur si thelbësore rëndësinë e ndikimit të kulturës dhe traditave në mendësi dhe në sjellje si dhe rolit kyç që ato kanë në kufizimin e të drejtave themelore të grave.³⁵ Gjithashtu, Konventa kërkon njohjen e *«përgjegjësisë së përbashkët të burrit dhe të gruas në edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve të tyre ...»*.

Së dyti, në nenin 9 Konventa vendos barazi midis burrit dhe gruas për sa i takon shtetësisë së bashkëshortëve dhe të fëmijëve. Kështu, *«as martesë me një të huaj, e as ndërrimi i shtetësisë së burrit gjatë martesës nuk e ndërrojnë automatikisht shtetësinë e gruas, po ashtu nuk e bën atë pa shtetësi dhe nuk e detyron të marrë shtetësinë e burrit»* dhe shtetet palë *«i japin gruas të drejta të barabarta me ato të burrit për sa i përket shtetësisë së fëmijëve të tyre»*.

Së treti, në nenin 15 të Konventës që parashikon njohjen barazisë ligjore midis burrit dhe gruas, vendoset ndër të tjera edhe detyrimi për shtetet palë që t'u njohin burrit edhe gruas *«të drejta të njëjta lidhur me legjislacionin që trajton të drejtën e personave për të lëvizur lirisht, si dhe për të zgjedhur vendbanimin dhe banesën e tyre»*.

Së katërti, neni 16 detyron të gjitha shtetet që të *«marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj gruas në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me martesën dhe me marrëdhëniet familjare»*. Në detajim të kësaj dispozite parashikohen e drejta dhe liria e plotë për të lidhur martesë si dhe përgjegjësi të barabartë si gjatë martesës ashtu edhe në rastin e prishjes së saj, si dhe *«të drejta të njëjta vetjake si burrit ashtu edhe gruas, duke përfshirë edhe të drejtën për të zgjedhur mbiemrin, profesionin dhe llojin e punës»*. Gjithashtu, në nenin 16 parashikohen edhe *«të drejtat dhe përgjegjësitë e njëjta si prindër, pavarësisht nga gjendja martesore, për ato çështje që kanë të bëjnë me fëmijët»*, ku në çdo rast interesi i fëmijëve duhet të jetë në vend të parë.

Neni 16 KEGJFDG, konsiderohet shumë i rëndësishëm nga Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Gruas (KEDG), pasi lidhet praktikisht me të gjitha implikimet gjinore të familjes, dhe për këtë arsye i kushton dy Rekomandime të Përgjithshme (RP), RP nr. 21 i titulluar *“Barazia në martesë dhe*

³⁵ Shiko Rekomandimin e Përgjithshëm nr.21 të Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Gruas.

marrëdhëniet familjare” dhe RP nr.29 “Pasojat ekonomike të martesës, marrëdhëniet familjare dhe zgjidhja e tyre”.³⁶

Në RP nr.21 KEDG bën një detajim të dispozitave që parashikojnë të drejtat dhe detyrimet në marrëdhëniet familjare duke u fokusuar në nenet 9 dhe 15 të Konventës, si dhe duke i kushtuar një vëmendje të dedikuar nenit 16. Përsa i përket nenit 9 të Konventës që lidhet me statusin e shtetësisë, interpretimi i KEDG është i tillë që të shkëpusë çdo lidhje të mundshme të humbjes së shtetësisë nga gruaja për shkak të divorcit, ose për shkak të ndërrimit të shtetësisë nga burri apo babai.

Në lidhje me nenin 15 të Konventës, ndër të tjera, KEDG bën një interpretim rekomandues të kuptimit të lirisë së lëvizjes dhe zgjedhjes lirisht të vendbanimit dhe banesës. Në lidhje me këtë të fundit, siç edhe në lidhje me shtetësinë, KEDG konstaton që në shumë vende gratë nuk janë të lira të vendosin për vendbanimin apo banesën familjare dhe për këtë arsye rekomandon shtetet që gruaja duhet të jetë e lirë për të zgjedhur vendbanimin pavarësisht statusit të saj si e martuar dhe për këtë duhet të ketë të drejta të barabarta me burrin. Sipas konstatimeve të KEDG, kufizimi i lirisë së gruas për të zgjedhur vendbanimin njësoj si burri, mund të kufizojë të drejtën e saj për akses në gjykatat e vendit ku jeton ose ta ndalojë që të hyjë e të dalë nga vendi në mënyrë të lirë.

Referuar nenit 16 të Konventës, KEDG fillimisht konstaton shqetësimin rreth roleve tradicionalisht të paracaktuara midis burrit dhe gruas në sferën private dhe familjare, duke theksuar pabarazinë dhe inferioritetin e gruas si pasojë e këtyre roleve. Ajo shkon edhe më tej duke evidentuar që edhe në rastet kur ligjërisht barazia midis burrit dhe gruas është e parashikuar, shoqëria gjithsesi cakton role të ndryshme duke e vendosur gruan në pozita inferiore. Për këtë arsye, edhe pse kushtetutat e shteteve dhe ligjet e tyre janë në përputhje me Konventën, janë pikërisht zakonet dhe traditat që krijojnë dështimin e implementimit të ligjeve e për rrjedhojë shkojnë kundër Konventës. Shpesh herë është në emër të ideologjive, traditave dhe zakoneve që justifikohet pabarazia në familje dhe diskriminimi kundër grave.³⁷

³⁶ Për efekt të studimit të fokusohemi të RP nr.21, ndërsa RP nr.29 rekomandohet për konsultim pasi shtjellon aspektin e pasojave ekonomike dhe statusit të gruas për shkak të pabarazisë në familje qasjeve diskriminuese kundrejt gruas.

³⁷ Shiko pikën 2 të RP nr.29.

Kjo gjë është e dukshme në disa vende përsa i përket të drejtës së njejtë për të lidhur martesë me pëlqimin e lirë dhe të plotë të gruas, si dhe për të zgjedhur lirisht bashkëshortin (Neni 16, paragrafi 1 shkronjat a dhe b).

E njehta qasje vërehet edhe në lidhje me të drejtat dhe përgjegjësitë gjatë martesës dhe në rastet e zgjidhjes së saj, ku shpesh herë ligjet dhe parimi i barazisë përthyhen në zbatim nga zakonet dhe traditat, në kufizim të të drejtave të gruas deri në atë pikë sa në shumë shtete burrit i njihet statusi i të qenit **Kryetar i Familjes** duke pasur në dorë të gjitha vendimmarrjet në familje (neni 16 paragrafi 1 shkronja c).³⁸ Ndërsa, të drejtën e përzgjedhjes së mbiemrit KEDG e lidh me barazinë, drejtësinë dhe përmbushjen individuale të çdo anëtari të familjes duke i njohur çdo bashkëshorti të drejtën e mbajtjes së **mbiemrit** të saj apo të tij. Kjo e drejtë lidhet me lirinë e personit si dhe me ruajtjen e individualitetit dhe identitetit të saj/tij në komunitet duke bërë atë të dallueshëm dhe unik ndaj çdo anëtari tjetër në shoqëri. Sipas KEDG, kudo që një grua është e detyruar prej ligjit apo zakoneve që të ndërrojë mbiemrin për shkak të martesës, asaj janë duke ju mohuar të drejtat që i garantohen nga Konventa.³⁹

Në përmbledhje të sa më sipër dhe në kuadër të analizës për efekt të këtij studimi, janë standarte të parashikuara në Konventë dhe të detajuara nga KEDG: barazia në të drejtat dhe detyrimet familjare midis burrit dhe gruas, përfshirë çdo aspekt që lidhet me fëmijët dhe zhvillimin e personit të tyre; ruajtja dhe mbrojtja e personalitetit dhe identitetit të bashkëshortëve dhe çdo anëtari të familjes; eliminimi i të gjitha pabarazive në familje që gjenerohen nga legjislacionet *de jure*, por sidomos nga sjelljet *de facto* për shkak kulture, zakonesh e traditash; zhbërja e figurës superiore të burrit në familje duke e vendosur familjen jo vetëm në baza barazie por edhe drejtësie midis anëtarëve.

3. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës.

Nisur nga parashikimet e DUDNJ dhe insistimi i konventave themeltare «*që mosha e fëmijërisë ka të drejtë për një përkujdesje dhe përkrahje të veçantë*», si dhe njëkohësisht që kjo mbrotje të jetë efektive duhet të garantohet edhe për familjen e fëmijës në mënyrë që kjo të jetë «*një mjedis natyror për rritjen dhe mirëqenien e të gjithë anëtarëve të saj dhe veçanërisht të fëmijës*», me qëllimin final «*zhvillimin e plotë dhe të harmonishëm të personalitetit të saj/tij [...] për një përgatitje të plotë*

³⁸ Shiko pikën 17 të RP nr.21.

³⁹ Shiko pikën 24 të RP nr.21.

për të bërë një jetë individuale në shoqëri»,⁴⁰ Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989 miraton Konventën për të Drejtat e Fëmijës.

Fryma e përgjithshme dhe parimi kryesor që karakterizon KDF është interesi më i lartë i fëmijës. Sipas nenit 3 të Konventës:

*1. Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, **interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.**⁴¹*

2. Shtetet Palë angazhohen që t'i sigurojnë fëmijës mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për mirëqenien e tij, duke pasur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tij, të kujdestarëve të tij ligjorë ose të personave të tjerë ligjërishit përgjegjës për të dhe, për këtë qëllim, ata marrin të gjitha masat legjislative dhe administrative përkatëse.

3. Shtetet Palë marrin masa që institucionet, shërbimet dhe qendrat që përgjigjen për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushën e sigurisë, të shëndetit, të numrit dhe aftësive të personelit të tyre si dhe të kontrollit të duhur.

Ndër shumë të drejta që i garantohen fëmijës të cilat kanë për qëllim mbrojtjen nga çfarëdolloj forme që mund të cenojë dinjitetin e saj/tij, si dhe promovimin me të gjitha mënyrat të zhvillimit të plotë të personalitetit, Konventa i kushton një rëndësi të veçantë lidhjes së fëmijës me familjen, rolin e kësaj të fundit si primar në zhvillimin e fëmijës dhe aspektit të identitetit si e drejtë themelore e fëmijës.

Së pari fëmija nuk mund të diskriminohet ndër të tjera për shkak të preardhjes familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij/saj. Në këtë kuptim, «Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë efektivisht i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinioneve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij». Ato (shtetet palë) duhet të respektojnë përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat që kanë prindërit (neni 5), të garantojnë që fëmija të mos ndahet nga prindërit kundër dëshirës së

⁴⁰ Shiko preambulën e KDF.

⁴¹ Për një kuptim më të gjerë të këtij parimi shiko Komentin e Përgjithshëm nr.14 (2013) të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës.

tyre (neni 9), të garantojnë ribashkimin e familjes (neni 10), mosndërhyrjen arbitrare ose të paligjshme në jetën private të fëmijës, në familje dhe në shtëpi (neni 16), të garantojnë një mjedis familjar për fëmijën (nenet 20,21), si dhe garantimin e këtyre të drejtave edhe në rastet e fëmijës me status refugjati (neni 22), fëmijëve me aftësi të kufiuar (neni 23).

Së dyti, Konventa i garanton fëmijës të drejtën për të pasur një emër si pjesë e personalitetit të tij/saj dhe garancinë e ruajtjes së identitetit të fëmijës. Kështu neni 7/1 KDF parashikon që *«fëmija regjistrohet menjëherë sapo lind dhe qysh atëherë ka të drejtën të ketë një emër, të drejtën për të fituar një shtetësi dhe, brenda mundësive, të drejtën për të njohur prindërit e tij dhe për të pasur kujdesin e tyre»* dhe shtetet palë duhet të marrin të gjitha masat për të siguruar zbatimin e kësaj të drejte.

Së treti, Konventa i kushton një dispozitë specifike aspektit identitar të fëmijës si një e drejtë themelore që lidhet me qenien e tij/saj si dhe me zhvillimin e personalitetit. Neni 8 KDF lidhet ekskluzivisht me identitetin e fëmijës dhe parashikon detyrimin për shtetet palë, që *«të respektojnë të drejtën e fëmijës për të ruajtur identitetin e tij, përfshirë këtu shtetësinë, mbiemrin dhe lidhjet familjare, sipas ligjit, pa ndërhyrje të paligjshme»*, si dhe në rast cenimi apo mohimi të disa apo të gjithë elementeve të identitetit të tij/saj, të marrin të gjitha masat që t'i japin *«ndihmën dhe mbrojtjen e duhur, me qëllim që identiteti i tij të rivendoset shpejt»*.

Siç vërehet pjesë e pandashme e personalitetit të fëmijës është identiteti i tij/saj, i cili ka disa elementë që konsiderohen esenciale dhe për të cilët Konventa kërkon që të garantohen dhe zbatohet efektivisht mbrojtja e tyre. Ky identitet lidhet me të drejtën individuale të fëmijës për tu regjistruar dhe pasur një emër, por edhe nevojën e një kuptimi të gjerë të identitetit të lidhur me përkatësinë familjare (mbiemri dhe marrëdhëniet familjare), si dhe përkatësinë kulturore dhe shoqërore (shtetësia). Në lidhje me këtë të fundit, Konventa kujdeset që të japë garanci për të zhvilluar personalitetin e fëmijës duke vendosur si qëllim kryesor të të drejtës për arsim që *«të rrisë respektin për prindërit e fëmijës, për identitetin e tij, gjuhën dhe vlerat kulturore, për vlerat kombëtare të vendit ku fëmija jeton, të vendit të origjinës dhe të qytetërimeve të ndryshme nga i veti»* (neni 29/1/c), duke i kushtuar vëmendje edhe aspektit identitar komunitar të fëmijëve pjesë të pakicave kombëtare (neni 30).

E lexuar Konventa në tërësinë e saj dhe nën frymën parimeve dhe vlerave si dhe të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës, interesi më i lartë i fëmijës është parimi

praktik që duhet të udhëheqë veprimtarinë shtetërore për garantimin e të gjitha të drejtave konventore dhe kombëtare të fëmijës, me qëllim zhvillimin e plotë të personalitetit të fëmijës. Pikënisja e një personaliteti të plotë është njohja e identitetit të fëmijës i cili mbrohet dhe promovohet natyrshëm brenda një mjedisi familjar. Që familja të kryejë plotësisht funksionin e saj në interesin e fëmijës duhet jo vetëm që ajo të jetë e mbrojtur nga shteti, por edhe të garantohet brenda saj parimi i barazisë midis bashkëshortëve si dhe në përgjegjësinë prindërore. Në këtë frymë, barazia gjinore midis burrit dhe gruas parashikon edhe ruajtjen e identitetit të bashkëshortëve brenda familjes, i cili më pas duhet të reflektohet edhe tek fëmijët për të pasur një zhvillim të plotë të personalitetit të tyre.

4. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe parimet e Këshillit të Europës.

Referuar parimit të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit, të drejtës për familje dhe mbrojtjes së saj, si dhe barazisë midis bashkëshortëve, Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) bën parashikime të rëndësishme.

Së pari, neni 14 (Ndalimi i diskriminimit) parashikon që *«gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër»*.⁴² Në zgjerim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përtej parashikimeve konventore, Protkollit 12 KEDNj në nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit),⁴³ bën të mundur zbatimin e parimit të mosdiskriminimit në shtetet palë jo vetëm në lidhje me të drejtat e parashikuara ekspresivisht në Konventë, por edhe për të gjitha të drejtat që shtetet i kanë njohur qytetarëve të tyre nëpërmjet legjislacioneve të tyre kombëtare.⁴⁴

Së dyti, nëpërmjet nenit 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), KEDNj i kushton rëndësi të drejtës së çdokujt për respektimin e *«jetës së tij*

⁴² Për një kuptim më të gjerë të nenit 14 dhe Prot.12 parë sidomos nga jurisprudence e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), shiko udhëzuesin e Këshillit të Europës:

https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_14_Art_1_Protocol_12_ENG.pdf

⁴³ Për një kuptim më të gjerë të Protokollit 12 KEDNj, shiko Raportin Shpjegues të Këshillit të Europës (KiE):

<https://rm.coe.int/09000016800cce48>

⁴⁴ **Neni 1 Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit Protokollit 12 i KEDNj**

1. *Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.*

2. *Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.*

private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij», duke specifikuar që «autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve».⁴⁵ Kjo dispozitë gjen një zbatim të gjerë në jurisprudencën e GjEDNj dhe kuptimi i përmbajtjes së saj ndër të tjera, përfshin aspekte të rëndësishme që lidhen me kuptimin individualist të njeriut, identitetin e tij, zhvillimin e personalitetit dhe sferën familjare. Sipas GjEDNj, «neni 8 i Konventës nuk përmban një dispozitë të qartë për temën e emrit, por që si një mjet identifikimi personal dhe lidhjes me një familje, emri i një personi nuk përfshin jetën e tij private dhe familjare. Fakti që shteti dhe shoqëria kanë interes në rregullimin e përdorimit të tij nuk mjafton për të përjashtuar çështjen e emrit të një personi nga fusha e jetës private dhe familjare, e cila është konceptuar që të përfshijë edhe të drejtën e individit për të krijuar marrëdhënie me bashkëqytetarët e tij».⁴⁶

Së treti, neni 12 KEDNj (E drejta për t'u martuar), parashikon që «burri dhe gruaja, që kanë mbushur moshën për martesë, kanë të drejtë të martohen dhe të krijojnë familje, sipas ligjeve kombëtare që rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte».⁴⁷ Në jurisprudencën e saj GjEDNj i ka dhënë kuptimin strikt kësaj dispozite duke u kufizuar vetëm në lirinë dhe aspektin e martesës, pa e përdorur implikimin e saj në të drejtat personale dhe familjare të cilat përfshihen tërësisht në nenin 8 KEDNj.

Së katërti neni 5 Prokollit 7 i KEDNj (Barazia ndërmjet bashkëshortëve), parashikon që «bashkëshortët gëzojnë barazinë e të drejtave dhe të përgjegjësisive me karakter civil midis tyre, si dhe në marrëdhëniet me fëmijët e tyre, në lidhje me martesën, gjatë martesës dhe gjatë zgjidhjes së saj. Ky nen nuk i pengon shtetet që të marrin masat e nevojshme në interes të fëmijëve». Ndryshe nga neni 12 KEDNj, kjo dispozitë nuk lidhet vetëm me aspektin e martesës, por edhe me marrëdhëniet gjatë dhe pas martesë, si dhe vendos një theks të fortë të parimit të barazisë midis bashkëshortëve.

Në bazë të këtyre parashikimeve konventore mbështeten një sërë të drejtash që lidhen me barazinë gjinore në familje, ruajtjen e identitetit dhe personalitetit pa

⁴⁵ Për një kuptim më të gjerë të nenit 8 KEDNj dhe jurisprudencës së GjEDNj, shiko udhëzuesin e KiE: https://www.echr.coe.int/documents/guide_art_8_eng.pdf

⁴⁶ Vendimi i GjEDNj Ünal Tekeli kundër Turqisë, para. 42.

⁴⁷ Për një kuptim më të gjerë të nenit 12 KEDNj dhe jurisprudencës GjEDNj, shiko udhëzuesin KiE: https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_12_ENG.pdf

diskriminim në marrëdhëniet familjare, si dhe zhvillimi i personalitetit të fëmijëve duke pasur gjithmonë parasysh interesin më të lartë të tyre. Pavarësisht këtyre parashikimeve, Komiteti i Ministrave pranë Këshillit të Europës (KiE) ka konstatuar progresivitet të garantimit të parimit të barazisë midis bashkëshortëve në legjislacionet kombëtare, por vë «*në dukje gjithsesi se diskriminimi ndaj bashkëshortëve ende ekziston në disa shtete dhe sanksionohet me dispozita ligjore*». Duke pasur parasysh promovimin e barazisë midis «*bashkëshortëve në të drejtën civile duke respektuar për aq sa është e mundur zakonet kombëtare*», si dhe «*domosdoshmërinë për të siguruar ose promovuar barazinë e bashkëshortëve në degë të tjera të së drejtës, veçanërisht në ligjet kushtetuese, administrative, fiskale, penale, sociale ose të punës*», Komiteti i Ministrave në 27 shtator 1978 miraton Rezolutën (78) 37 “*Mbi barazinë e bashkëshortëve në të drejtën civile*”.⁴⁸

Kjo Rezolutë bën parashikime të rëndësishme dhe rekomandon marrjen e masave nga ana shteteve palë, të rregullimeve legjislative dhe zbatimit të ligjeve në funksion të një barazie reale gjinore midis burrit dhe gruas në marrëdhëniet civile e më specifikisht në ato familjare. Si parime të përgjithshme, kjo Rezolute vendos në radhë të parë mosdiferencimin midis bashkëshortëve mbi baza gjinie «*sipas të cilave njëri nga bashkëshortët të vihet në një pozitë më të favorshme se bashkëshorti tjetër*», gjë që bëhet shumë evidente sidomos në rastet kur parashikohet pozicioni i Kryefamiljarit, i cili dominon plotësisht aspektin vendimmarrës dhe përfaqësues në familje duke vendosur në pozita diskriminuese në bazë gjinie bashkëshortin tjetër. Në radhë të dytë, në funksion të një arritje efektive të barazisë thelbësore midis bashkëshortëve, Rezoluta vendos si parim kryesor marrëveshjen midis bashkëshortëve për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme, dhe shtetet duhet të marrin masa që në rast mos arritje dakordësie legjislacioni të mos jetë diskriminues në baza gjinore.

Ndër shumë parashikime konkrete që lidhen me barazinë efektive të bashkëshortëve si lëvizja e lirë në kushte të barabarta (pika 3 e Rezolutës), barazia në ushtrimin e aktivitetit tregtar, profesionit dhe vazhdimin të studimeve (pika 4), barazia në shpenzimet për familjen dhe aspektet financiare (pika 8), në kontratat martesore (pika 10), në regjimin pasuror (pika 12), në administrimin dhe ndarjen e pasurisë gjatë martesës dhe në zgjidhjen e saj (nenet 13,14,15,16), si dhe në lidhje me fëmijët (nenet 18,19), Rezoluta bën dhe parashikime specifike në lidhje me identitetin e bashkëshortëve dhe fëmijëve të tyre.

⁴⁸ <https://rm.coe.int/res-78-37e-on-the-equality-of-spouses-in-civil-law/1680a3b3f1>

Kështu, në radhë të parë Rezoluta i kushton rëndësi barazisë midis bashkëshortëve në lidhje me ruajtjen e identitetit të tyre duke ju referuar specifikisht një ndër elementeve kryesore që është ai i mbiemrit. Sipas pikës 6 të Rezolutës, shtetet duhet të rregullojnë «*çështjet në lidhje me mbiemrin e bashkëshortëve për të siguruar që bashkëshortit nuk i kërkohet me ligj të ndryshojë mbiemrin e tij për të adoptuar mbiemrin e bashkëshortit tjetër*». Në detajim të kësaj, Rezoluta ofron dhe zgjidhje konkrete që mund dhe duhet të mbahen parasysh nga shtetet palë:

i. zgjedhja e një mbiemri të përbashkët në marrëveshje me bashkëshortin tjetër, veçanërisht mbiemri i njërit prej bashkëshortëve, mbiemri i formuar nga shtimi i mbiemrave të të dy bashkëshortëve ose një mbiemër të ndryshëm nga mbiemri i secilit bashkëshort;

ii. mbajtja nga secili bashkëshort e mbiemrit që ka pasur para martesës;

iii. formimi i një mbiemri të përbashkët në bazë të ligjit me shtimin e mbiemrave të të dy bashkëshortëve;

Gjithashtu, në rastet e zgjidhjes së martesës legjislacionet duhet të lejojnë që «*secili bashkëshortët të mbajë mbiemrin e përbashkët, përveç rastit kur [...] njëri prej bashkëshortëve ka marrë një vendim nga autoriteti përkatës që i kërkon ish-bashkëshortit të mos përdorë mbiemrin e përbashkët, për arsye të rënda, e cila zbatohet njëllor për të dy bashkëshortët*» (pika 7).

Së dyti, në funksion të barazisë midis bashkëshortëve shtetet anëtare duhet të sigurojnë që «*[...]të dy bashkëshortët kanë të drejta të barabarta për të zgjedhur vendbanimin e përbashkët të familjes dhe që secili bashkëshort të ketë të drejtë të barabartë për një vendbanim të veçantë nga ai i bashkëshortit tjetër, në rastet kur i jepet kjo e drejtë*» (pika 5).

Së treti, në mbrojtje të parimit të barazisë në lidhje me fëmijët dhe identitetin e tyre pika 17 e Rezolutës parashikon që shtetet të ndërmarrin hapat e nevojshëm «*[...] për t'u lejuar të dy bashkëshortëve të drejta të barabarta përsa i përket mbiemrit që u jepet fëmijëve të lindur nga martesa e tyre, ose fëmijëve të birësuar prej tyre [...]*». Në funksion të kësaj, në lidhje me raste specifike Rezoluta jep zgjidhje konkrete. Në rastin kur prindërit nuk kanë një mbiemër të përbashkët rekomandohet që fëmija të ketë mundësi «*[...] të marrë mbiemrin e prindit, i cili nuk i është dhënë me ligj*», ose të parashikohet që «*[...] mbiemri i fëmijëve të zgjidhet me marrëveshje të përbashkët të prindërve*». Ndërsa, në rastet kur prindërit kanë, përveç mbiemrave të tyre të familjes, një mbiemër të përbashkët i

cili ose është zgjedhur prej tyre ose është formuar si pasojë e zbatimit të ligjit, të garantohet që «[...] lëshimi i pjesës së mbiemrit të familjes nuk duhet të përbëjë diskriminim në lidhje me zgjedhjen e mbiemrit të familjes ose mbiemrit që duhet të hiqet».

Duke parë ndër vite që zbatimi i Rezolutës (78) 37 “Mbi barazinë e bashkëshortëve në të drejtën civile”, akoma nuk ka gjetur zbatim në shumë vende anëtare të Këshillit të Europës, Asambleja Parlamentare (AP) e KiE miraton në kohë të ndryshme dy Rekomandime me përmbajtje identike: Rekomandimi 1271 (1995) “Diskriminimi midis burrave dhe grave në zgjedhjen e mbiemrit dhe në kalimin e mbiemrave të prindërve tek fëmijët”⁴⁹ dhe Rekomandimi 1362 (1998) me të njëjtin emërtim.⁵⁰

Me anë të këtyre dy Rekomandimeve, Asambleja Parlamentare e KiE bën disa konstatime të rëndësishme dhe njekohësisht shpreh shqetësime në lidhje me respektimin e paramit të barazisë me bazë gjinore në shtetet anëtare.

Së pari, ajo shpreh shqetësimin për mos marrjen në konsideratë të Rezolutës (78) 37 nga ana e disa shteteve anëtare dhe shprehet e befasuar për faktin se shumë nga këto shtete janë edhe palë të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave.

Së dyti, AP konstaton që edhe pse ka njëfarë progresi në ndryshimin e legjislacioneve, «vende të tjera kanë ruajtur sistemet tradicionale ligjore të bazuara në kritere të cilat shpesh janë dyfish diskriminuese: diskriminuese ndërmjet nënës dhe babait dhe diskriminuese për sa i përket faktit nëse fëmija ka lindur brenda ose jashtë martesë».

Së treti, AP i kujton shteteve anëtare «se emri është një element që përcakton identitetin e individëve dhe se, për këtë arsye, zgjedhja e emrit është një çështje me rëndësi të konsiderueshme», për rrjedhojë «diskriminimi i vazhdueshëm midis burrave dhe grave në këtë fushë është i papranueshëm».

Së katërti, AP tërheq vëmendjen në zbatimin e Rezolutës (78) 37 në lidhje me «eliminimin diskriminimit midis burrave dhe grave në sistemin ligjor që rregullon mbiemrat» dhe marrjen e masave të nevojshme «për të eliminuar të gjitha dispozitat seksiste në lidhje me të drejtën për të zgjedhur mbiemrin», në zbatim të nenit 16 KEGJFDKG.

⁴⁹ <https://pace.coe.int/en/files/15305/html>

⁵⁰ <https://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=16599&lang=en>

Së pesti, AP i kërkon Komitetit të Ministrave që të identifikojë shtetet anëtare «që ruajnë diskriminimin seksist» me qëllim marrjen e masave për:

- *zbatimin e një barazie strikte ndërmjet nënës dhe babait në kalimin e mbiemrit fëmijëve të tyre;*
- *sigurimin e një barazie strikte në rast martesë në lidhje me zgjedhjen e një mbiemri të përbashkët për të dy bashkëshortët;*
- *eliminimin e çdo diskriminimi në sistemin ligjor lidhur me dhënien e mbiemrit ndërmjet fëmijëve të lindur brenda dhe atyre të lindur jashtë martesë.*

Edhe pse dy organe të rëndësishme të Këshillit të Europës siç janë Komiteti i Ministrave dhe Asambleja Parlamentare, prej kohësh kanë ngritur shqetësimin mbi diskriminimin gjinor midis bashkëshortëve dhe në identitetin e fëmijëve, rezulton që në shumë shtete anëtare ndryshimet legjislative kanë qenë të ngadalta dhe sërish në mospërputhje me frymën e parimeve të KiE. Për një implementim më efikas të Rezolutës (78) 37 dhe Rekomandimeve të AP 1271 (1995) dhe 1362 (1998), por sidomos për një kuptim më të drejtë të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, përfshihet edhe Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut e cila merr në analizë konkrete legjislacione kombëtare të shteteve anëtare të KiE.

5. Jurisprudenca e GjEDNj në lidhje me mbiemrin e familjes dhe respektimin e barazisë gjinore në identitetin prindëror të fëmijëve.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka një jurisprudencë të pasur për çështje që lidhen me mosrespektimin e nenit 14 të KEDNj-së, sidomos të mosrespektimit të këtij neni në bashkëpunim me nenin 8 KEDNj. Në këtë drejtim, përmes praktikës së saj ajo ka siguruar që të respektohet parimi i barazisë midis burrit dhe gruas si dhe dinjteti i personit dhe personaliteti i tij. Sidomos në marrëdhëniet familjare në të gjithë dimensionin e tyre, GjEDNj ka elaboruar një jurisprudencë evolutive të kuptimit të këtyre dispozitave duke zgjeruar interpretimin e tyre me qëllim përfshirjen e sa më shumë të drejtave por dhe duke ofruar një kuptim të ri të të drejtave, më gjithëpërfshirës në kuptimin e barazisë e njëkohësisht më të ndjeshëm ndaj lirive individuale në kuptim të dinjtetit të njeriut.

Edhe pse shpesh parimi i barazisë dhe ai i lirisë individuale janë në kontradiktë dhe marrin hapësirë nga njëra tjetra për realizimin e tyre, në praktikën e GjEDNj në lidhje me kuptimin e personit në familje, ajo arrin ti bëjë të bashkëtojnë këto të drejta me njëra tjetrën në mënyrë që të plotësohen, duke i balancuar ato me

parimin e interesit publik dhe traditave e zakonet që prej shekujsh janë krijuar në shoqëritë e shteteve anëtare të KEDNj. Në këtë kuptim, GjEDNj është e vetëdijshme për ndikimin e traditave dhe zakoneve në marrëdhëniet familjare, por njëkohësisht i njëh këtyre marrëdhënieve dhe karakter publik.

Ndikimi i traditave dhe zakoneve që më pas janë reflektuar në legjislacionet e shteteve, është i njohur në të gjitha konventat e të drejtave, sidomos në krijimin dhe mbajtjen e pabarazisë midis burrit dhe gruas duke i njohur dhe garantuar të parit një pozicion dominues në sferën familjare. Në këndvështrimin e GjEDNj, është ngurtësimi i traditave dhe zakoneve bashkërisht me interesin publik që gjenerojnë pabarazi gjinore midis burrit dhe gruas. Është pikërisht hapësira e këtyre parimeve që fillon të gërryhet nga GjEDNj për ti dhënë hapësirën e duhur barazisë, lirisë individuale dhe dinjitetit të njeriut.

Në këtë kuptim është përpjekje e vazhdueshme e GjEDNj në praktikën e saj që kërkon vendosjen e një ekuilibri midis respektimit të këtyre të drejtave dhe interesit publik, traditave apo ruajtjes së unitetit të familjes që zakonisht shtetet vendosin si parime prevalente.

Në vijim, do të prezantohen disa çështje në të cilat GjEDNj fillimisht është marrë me vendosjen e barazisë reale në familje midis burrit dhe gruas, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë ruajtjes së identitetit të bashkëshortëve si pjesë e dinjitetit të tyre. Më pas, në evolucionin e jurisprudencës së saj, GjEDNj ka reflektuar garantimin e barazisë reale midis burrit dhe gruas edhe në identitetin e fëmijëve, duke konsideruar këtë gjë esenciale për zhvillimin e personalitetit të tyre.

Janë në interes të këtij studimi parimet që dalin nga jurisprudenca e GjEDNj në lidhje me barazinë gjinore midis bashkëshortëve dhe identitetit prindëror të fëmijëve, si dhe sugjerimet praktike që GjEDNj jep për përshtattjen e legjislacioneve në përputhje me nenet 8 dhe 14 KEDNj.

5.1 Çështja Ünal Tekeli kundër Turqisë (2004)⁵¹

Pas lidhjes së martesës, kërkuesja mori automatikisht mbiemrin e burrit në përputhje me dispozitat e Kodit Civil turk të kohës. Ajo ushtronte profesionin si praktikante avokate në kohën e martesës së saj. Duke qenë se ajo njihej me mbiemrin e vajzërisë në jetën profesionale, kërkesa e saj ishte që të mbante vetëm mbiemrin e saj pas martese. Kërkesa e saj u rrëzua me arsyetimin se ligji i

⁵¹ Në këtë vendim GjEDNj zgjeron dhe qartëson në kuptim parimet e vendosura në një vendimi të mëparshëm, Burghartz kundër Zvicrës (1994).

brendshëm turk parashikonte që gratë e martuara duhet të mbanin mbiemrin e burrit gjatë gjithë jetës së tyre martesore. Në vitin 2001 Kodi Civil turk u ndryshua më pas për t'i lejuar gratë e martuara të mbajnë mbiemrin e tyre të vajzërisë së bashku me mbiemrin e burrit. Ndër të tjera, me qëllim zbehjen e traditave dhe të rolit primar të burrit në famije, legjislatori turk shfuqizoi edhe dispozitën që parashikonte burrin si kryetar të familjes.

Megjithatë, kërkuesja kërkonte të mbante vetëm mbiemrin e vajzërisë si mbiemër të saj pas martese gjë e cila edhe pas ndryshimeve të miratuara nuk ishte e lejuar, pavarësisht se midis bashkëshortëve kishte konsensus për këtë gjë. Ajo konsideronte se ishte e diskriminuar në krahasim me burrat e martuar pasi këto mund të mbanin mbiemrin e tyre pas martese, ndërsa gratë jo.

Gjykata konstatoi se shteti turk kishte shkelur nenin 8 së bashku me nenin 14 të KEDNj-së dhe argumentoi se mbiemri i familjes luan një rol të rëndësishëm pasi ndikon dhe identifikon një person në jetën private dhe familjare dhe lidhet me aftësinë për të krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie sociale, kulturore ose të tjera me qeniet e tjera njerëzore (para. 35). Njëkohësisht, mbiemri ka dhe një relevancë publike dhe në rastin konkret argumentat e shtetit turk këtë interes e lidhnin ekskluzivisht me «*ruajtjen e unitetit të familjes*», si pjesë të traditës.⁵² Gjithsesi, refuzimi për të lejuar kërkuesen të përdorte vetëm mbiemrin e saj të vajzërisë, me të cilin ajo pretendonte se ishte njohur në rrethin e saj privat dhe në veprimtaritë e saj kulturore apo politike, mund të kishte ndikuar ndjeshëm në veprimtaritë e saj profesionale, si dhe në identitetin e saj si person.

Sipas Gjykatës, Konventa kërkon që çdo masë e ndërmarrë për të pasqyruar unitetin e familjes duhet të zbatohet në mënyrë të barabartë si për burrat ashtu edhe për gratë, përveç rasteve kur paraqiten arsye të ndryshme bindëse. Në këtë kontekst, «*duhet rikujtuar se ndërkohë që uniteti familjar mund të jetë i reflektuar duke zgjedhur mbiemrin e burrit si mbiemër, ai unitet mund të reflektohet po aq mirë duke zgjedhur mbiemrin e gruas ose një mbiemër të përbashkët të përzgjedhur nga bashkëshortët*» (para.64 i vendimit).

Gjykata nënvizoi se sipas praktikës së shteteve palë dhe sistemeve të zbatueshme në Evropë, ishte krejtësisht e mundur që uniteti i familjes të ruhej dhe

⁵² Pyetja e parë për Gjykatën është nëse tradita e reflektimit të unitetit familjar nëpërmjet mbiemrit të burrit mund të konsiderohet si faktor vendimtar në rastin konkret. Pa dyshim, kjo traditë rrjedh nga roli primar i burrit dhe roli dytësor i gruas në familje. Në ditët e sotme avancimi i barazisë së gjinive në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, duke përfshirë Turqinë, dhe në veçanti rëndësia e parimit të mosdiskriminimit, ndalojnë shtetet që t'ia imponojnë këtë traditë grave të martuara. (para.63)

konsolidohej aty ku një çift i martuar zgjidhte të mos mbante një mbiemër të përbashkët. Sipas Gjykatës, qeveria turke në rastin konkret nuk arriti të tregonte vështirësitë konkrete ose thelbësore për partnerët e martuar dhe/ose palët e treta ose dëmtimin e interesit publik që mund t'i vinte unitetit familjar nëpërmjet mungesës së një mbiemri të përbashkët familjar.

Në ato rrethana, Gjykata vlerësoi se detyrimi i grave të martuara, në emër të unitetit familjar, për të mbajtur detyrimisht mbiemrin e burrit apo edhe në rastet kur mund të vendosnin mbiemrin e vajzërisë bashkë me mbiemrin e burrit, nuk përbënte asnjë arsytim objektiv dhe të arsyeshëm për të mos lejuar vetëm mbajtjen e mbiemrit të vajzërisë.

Gjykata mban parasysh edhe faktin që kalimi nga një sistem tradicional në sisteme të tjera që u mundësojnë partnerëve të martuar ose të mbajnë mbiemrin e tyre ose të zgjedhin lirisht një mbiemër të përbashkët, mund të ketë një efekt të konsiderueshëm në mbajtjen e regjistrave të lindjeve, martesave dhe vdekjeve. Gjithsesi, ajo thekson se mund të pritët në mënyrë të arsyeshme që shoqëria të tolerojë një shqetësim të tillë për të mundësuar individët të jetojnë me dinjitet dhe vlerë në përputhje me mbiemrin e zgjedhur. Në përfundim, sipas GjEDNj objektivi i arritjes së unitetit të familjes nëpërmjet një mbiemri të përbashkët nuk mund të përbëjë një justifikim për dallimin në trajtim për shkak të gjinisë.⁵³

5.2 Çështja Cusan dhe Fazzo kundër Italisë (2014)

Kërkuesit janë një çift italian i martuar me banim në Milano. Në vitin 1999 lindi vajza e tyre dhe ata u përpoqën bashkërisht që ta regjistronin atë me mbiemrin e nënës (Cusan). Kërkesa u refuzua dhe nëpunësi i gjendjes civile i vendosi vajzës automatikisht mbiemrin e babait. Prindërit u ankuan në gjykatën e shkallës së parë, e cila e rrëzoi kërkesën e tyre duke deklaruar se megjithëse nuk kishte asnjë parashikim të mirëfilltë ligjor që fëmija duhej të regjistrohej me mbiemrin e babait, kjo bazohej në traditën dhe zakonet italiane e kuptuar edhe në bazë të legjislacionit të mëparsëm i cili njihte si kryesor figurën e babait në familje. Prindërit vijuan më tej me apelimin e vendimit ku u konfirmua vendimi i gjykatës së shkallës së parë.

⁵³ Konsolidimin e këtyre parimeve (barazisë gjinore kundrejt unitetit të familjes) GjEDNj e përçon edhe në Çështjen Losonci Rose dhe Rose kundër Zvicrës (2010), ku cenimi i parimit të barazisë midis bashkëshortëve ndërlihej edhe me shtetësinë e tyre. Edhe në këtë rast, respektimi i barazisë midis burrit dhe gruas në aspektin e mbiemrit dhe identitetit të tyre duhet garantuar edhe në rastin e martesës së dy personave me shtetësi të ndryshme dhe legjislacionet vendase nuk duhet të tolerojnë diskriminim.

Gjykata e Kasacionit e Italisë pezulloi shqyrtimin e çështjes dhe e dërgoi çështjen për shqyrtim në formën e kontrollit incidental në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese vlerësoi se sistemi italian ishte rezultat i një këndvështrimi patriarkal të familjes me rrënjë në të drejtën romake dhe ishte i papajtueshëm me parimin kushtetues të barazisë midis burrave dhe grave. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese e konsideroi veten të pamundur për të ndërhyrë, duke konstatuar se i takon legjislatorit që të miratojë një zgjidhje në përputhje me parimet e barazisë, për të drejtat e fëmijës dhe parimin e unitetit të familjes.

Në vitin 2011 ankuesit morën autorizimin e ministrit të brendshëm për të shtuar edhe mbiemrin e nënës bashkë me atë të babait, në mënyrë që fëmija të mund të mbante të dy mbiemrat (Fazzo dhe Cusan). Megjithatë, atyre iu ndalua që të regjistronin fëmijën e tyre vetëm me mbiemrin e nënës. Ankuesit paraqitën një kërkesë në GjEDNj duke pretenduar se me ndalimin e vendosjes së mbiemrit të nënës, qeveria italiane i ka shkelur atyre të drejtën për jetë private dhe familjare, si dhe për mosdiskriminim, sipas neneve 8 dhe 14 të KEDNj. Për më tepër, ankuesit pretenduan shkelje të së drejtës për barazi ndërmjet bashkëshortëve (neni 5 i Protokollit 7) vetëm ose marrë së bashku me dy nënet e sipërpërmendura.

Së pari, GjEDNj përfshin pa hezitim të drejtën për emër dhe mbiemër të çdo personi në nenin 8 KEDNj, duke i njohur ato si shumë të rëndësishme për identifikimin e personit e për rrjedhojë pjesë të pandashme të jetës së tij private dhe familjare. Gjithashtu, sipas GjEDNj «*fakti që shteti dhe shoqëria kanë interes në rregullimin e përdorimit të tyre nuk është i mjaftueshëm për të përjashtuar çështjen e mbiemrit të personave nga fusha e jetës private dhe familjare, e kuptuar si përfshirëse e të drejtës së individit për të ndërtuar marrëdhënie me të ngjashmit e tij*» (paragrafi 55).

Së dyti, në lidhje me drejtën për mosdiskriminim sipas nenit 14, GjEDNj rimerr në thelb jurisprudencën e mëparshme duke ritheksuar edhe njëherë parimin e barazisë gjinore midis bashkëshortëve, si dhe zhdukjes së çdo diskriminimi në bazë të seksit në zgjedhjen e mbiemrit. Kështu, nisur nga interpretimi i dispozitave të legjislacionit italian të cilat të lexuara së bashku nën frymën e traditave sipas të cilës figura predominante në familje është ajo e babait, aplikimi i tyre në thelb cenon parimin e barazisë midis bashkëshortëve në baza gjinore. Prandaj, GjEDNj është e mendimit se, në kontekstin e dhënies së mbiemrit, babai dhe nëna e fëmijës trajtohen ndryshe pa ndonjë arsye objektive apo qëllim të

ligjshëm. Ndryshe nga babai dhe përkundër marrëveshjes midis bashkëshortëve, fëmija nuk mund të marrë mbiemrin e nënës.

Në rastin konkret, zgjedhja e mbiemrit të fëmijës përcaktohej vetëm në bazë të gjinisë së prindërve, pasi rregulli në fjalë kërkonte që mbiemri i dhënë të ishte ai i babait, pa përjashtim dhe pavarësisht nga zgjedhja e bërë nga bashkëshortët. Vetë Gjykata Kushtetuese Italiane kishte pranuar se sistemi në fuqi i kishte rrënjët në një koncept patriarkal të familjes, i cili nuk ishte në përputhje me parimin kushtetues të barazisë midis burrave dhe grave. GjEDNj konstatoi se praktika e lejit të babait, por jo nënës, t'i jepte mbiemrin një fëmije, rezultoi në trajtim të pabarabartë të babait dhe nënës pasi ndryshimi në trajtim ndodhte vetëm për shkak të gjinisë së ndryshme të dy prindërve.

Në këtë kuptim, vendosja nga ana e Shtetit Italian të realizimit të interesit publik nëpërmjet unitetit të familjes, nuk mund të përbëjë një shkak të ligjshëm për mosaplikimin e parimit të barazisë në baza gjinore, pasi ekzistojnë mënyra të ligjshme dhe proporcionale për garantimin e parimit të barazisë dhe realizimin e interesit publik pa cenuar njera tjetrën. Në këtë këndvështrim, nuk kuptohet sipas GjEDNj, përse uniteti i familjes nuk mund të ruhet duke lejuar që të vendoset vetëm mbiemri i nënës, prandaj dhe koncepti tradicional patriarkal sipas të cilit uniteti i familjes garantohet vetëm nga mbiemri i babait është diskriminues kundrejtë grave.

5.3 Çështja León Madrid kundër Spanjës (2021)

Më 9 nëntor 2005, aplikuesja lindi një vajzë e cila fillimisht u regjistrua me mbiemrin e nënës. Në një vendim të datës 14 shkurt 2007, gjykata kompetente pranoi atësinë biologjike të ish-partnerit të nënës. Më tej, në përputhje me legjislacionin në fuqi, gjykata vendosi që fëmija duhej të mbante, mbiemrin e babait të saj pasuar nga ai i nënës së saj. Në kërkesat e saj nëpër gjykata, përfshirë edhe Gjykatën Kushtetuese spanjolle, ishte që të paktën mbiemri i saj të vendosej para mbiemrit të babait. Kërkesa e kërkueses për ndryshimin e mbiemrave të mbajtur nga vajza e saj e mitur u refuzua.

Në thelb ankuesja pranonte që fëmija të mbante të dy mbiemrat, por kontestonte faktin që në rastet e mosmarrëveshjes midis prindërve, mbiemri i babait vendosej automatikisht i pari, pa pasur parasysh rrethanat dhe e konsideronte këtë parashikim ligjor që i jepte prioritet babait të mbeshtetur ekskluzivisht në bazë gjinie. Rrethana kryesore që ankuesja vendoste si përcaktuese në rastin

konkret ishte që babai nuk kishtë jetuar asnjë ditë me fëmijën dhe kishte qenë shtysë për partneren që ta abortonte atë.

Një nga kontestimet lidhej me faktin që neni 194 i Rregullores për gjendjen civile, ishte miratuar në vitet 1950, atëhere kur legjislacioni favorizonte më shumë burrat kundrejtë grave dhe për rrjedhojë përforcontë më shumë të drejtat e babait sesa të nënës.

Parimi për tu balancuar nga ana e Qeverisë ishte ai i interesit publik. Në këtë kuptim ajo argumenton që prindërit duhet të bëjnë marrëveshje për çështjet e mbiemrit të fëmijës, por për të garantuar sigurinë juridike dhe mbrojtjen e të miturve, vendosej automatikisht mbiemri i babait, pasi nëse nuk vendosej mbiemri i babait, fëmijë me prindër të njejtë mund të kishin mbiemra të ndryshëm e për rrjedhojë cenohen të drejtat personale të fëmijëve.

Ndërkohë, pikërisht për një ekuilibrim më të mirë të të drejtave dhe parimeve, legjislatori spanjoll ndërhyr në vitin 2011 duke ndryshuar dispozitën. Sipas dispozitës së re, në rast mosmarrëveshje midis prindërve në lidhje me mbiemrin e fëmijës është gjykata ajo që vendos rast pas rasti duke mbajtur parasysh parimin e interesit më të lartë të fëmijës. Kjo dispozitë e re, nuk mund të aplikohet në rastin e ankueses.

Në mendimin e GjEDNj, së pari, në legjislacionin spanjoll ka pasur një trajtim të diferencuar të prindërve vendosur ekskluzivisht në bazë gjinie.

Së dyti, kjo gjë ka ndodhur për shkak të konceptit patriarkal që predominonte shoqërinë spanjolle në momentin kur janë miratuar dispozitat. Vetë legjislatori, në relacionin shpjegues të ligjit ndryshues në vitin 2011, ka pranuar se qëllimi kryesor i ndryshimeve është që të bëjë të mundur barazinë gjinore duke eliminuar traditat që mund ta cenojnë atë. Në këtë mënyrë mendimi i legjislatorit shkon në linjë me jurisprudencën e GjEDNj sipas të cilës, nuk mund të cenohet parimi i barazisë gjinore për shkak të traditave të një vendi.

Së treti, GjEDNj tërheq vëmendjen në lidhje me arsyetimin e garantimit të interesit publik duke vendosur automatikisht mbiemrin e babait, si të paarsyeshëm. Edhe njëherë ajo cilëson se është diskriminues fakti i vendosjes automatikisht i mbiemrit të babait për garantimin e interesit publik nëpërmjet sigurisë juridike, kur e njehta gjë mund të arrihet duke vendosur mbiemrin e nënës.

Sic vërehet nga jurisprudenca e GJEDNj në lidhje me kuptimin e të drejtave në KEDNj, sfidë mbetet balancimi i garantimit të tyre me legjislacionet vendase të cilat akoma ushqejnë aspekte të pabarazisë gjinore në marrëdhëniet familjare duke i njohur një predominancë rolit të burrit, kryesisht nën ndikimin e kulturës dhe traditës të cilat pastaj rezultojnë kufizuese të të drejtave në formën e interesit publik të garantuar nga uniteti i familjes. Jurisprudenca e GJEDNj nuk konsideron thelbësisht negative kulturat dhe traditat vendase të shteteve anëtare, si dhe ndërtimin e interesit publik bazuar në to, por ajo merr në konsideratë rast pas rasti nëse reflektimi i traditave në legjislacion apo në veprimtarinë e administratës bën një balancim proporcional apo jo me parimin e barazisë, identitetin e personit dhe dinjitetin njeriut. Në të gjitha ato raste kur diferencimi gjinor, si në marrëdhënien bashkëshortore ashtu edhe në marrëdhëniet kundrejtë fëmijëve, nuk gjen një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv dhe njëkohësisht nuk cenon realisht interesin publik, do të konsiderohet diskriminues dhe cenes i parimit të barazisë gjinore sipas KEDNj.

II. Analizë e legjislacionit shqiptar dhe praktika e administratës.

Kushtetututa e Shqipërisë (KSH) bën parashikime të rëndësishme në lidhje me dinjitetin e njeriut, parimin e barazisë dhe familjen. Kështu, dinjiteti i njeriut vendoset që në preambulën e Kushtetutës si vlerë për tu mbrojtur dhe gjen vend në nenin 3 KSh ku ndër të tjera «... *dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij...*», janë baza e shtetit shqiptar që ka për detyrë ti mbrojë dhe respektojë. Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit parashikohet në nenin 18 KSh, i cili parashikon që «*të gjithë janë të barabartë përpara ligjit*» dhe askush nuk mund të diskriminohet, ndër të tjera, për shkaqe të tilla si gjinia, gjendja sociale apo përkatësia prindërore.

Parimi i barazisë në Shqipëri lejon trajtime të ndryshme në situata të njejta por vetëm në rast përlligje të arsyeshme dhe objektive. Për fëmijët, të rinjtë, gratë shtatëzëna dhe nënat e reja Kushtetuta garanton mbrojtje të veçantë, ndërsa ndalon diskriminimin apo trajtimin ndryshe midis fëmijëve të lindur brenda apo jashtë martese. Gjithashtu, neni 53 parashikon të drejtën e kujtudo për të krijuar familje duke i garantuar martesës dhe familjes mbrojtje të veçantë nga shteti dhe duke ja deleguar çdo rregullim ligjit. Ndryshe nga kushtetuta të tjera europiane, Kushtetuta e Shqipërisë nuk bën parashikime në lidhje me personalitetin e njeriut, parimit individualist apo zhvillimit të personit.⁵⁴ I vetmi parashikim qendron në preambulën e saj ku ndër të tjera parashikohet mbrojtja e «*personalitetit njerëzor*».

1. Në lidhje me mbiemrin

Për një kuptim më të gjerë të personalitetit të njeriut dhe sidomos aspektit identitar të tij, si dhe të kuptimit të parimit të barazisë gjinore në familje, vështrimi duhet hedhur në legjislacionin shqiptar. Në Kodin Civil (KC) të Shqipërisë (Ligj 7850, datë 29.07.1994, i ndryshuar) parashikohet e drejta e emrit si një e drejtë individuale e njeriut që lidhet direkt me të drejtat subjektive të tij. Neni 5 KC parashikon që çdo person «*ka të drejtën dhe detyrimin të ketë*

⁵⁴ Sipas nenit 2 të Kushtetutës Italiane, «*Republika njej dhe garanton të drejtat e padhuneshme të njeriut, qoftë si individ, qoftë në formacionet shoqërore ku zhvillohet personaliteti i tij, dhe kërkon kryerjen e detyrave të domosdoshme të solidaritetit politik, ekonomik e shoqëror*».

Sipas nenit 10/1 të Kushtetutës Spanjolle, «*Dinjiteti i personit, të drejtat e pacenueshme të tij, zhvillimi i lirë i personalitetit, respektimi i ligjit dhe i të drejtave të të tjerëve janë themeli i rendit politik dhe i paqes shoqërore*».

Sipas nenit 2/1 të Kushtetutës Gjermane, «*Secili ka të drejtën e zhvillimit të lirë të personalitetit të tij, përderisa nuk cenon të drejtat e të tjerëve dhe nuk shkel rendin kushtetues apo ligjin moral*».

emrin dhe mbiemrin e tij që i vihen sipas ligjit», duke e mbrojtur atë nga çdo cenim apo mohim të përdorimit. Njëkohësisht, Kodi Civil e zgjeron mbrojtjen e emrit duke mos e lënë atë një të drejtë ekskluzivisht personale por duke e lidhur edhe me interesa familjarë.

Gjithsesi, parashikimi i Kodit Civil mbetet i përgjithshëm, ndërsa për një kuptim të thelluar të rëndësisë së identitetit të personit është Kodi i Familjes (KF)⁵⁵ dhe Ligji nr.10129 datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile”, i ndryshuar, që japin karakteristikat thelbësore.

Nga aspekti i gjendjes civile mbiemri është një nga përbërësit identifikues të personit, krahas emrit, numrit personal, datëlindjes, vendlindjes, gjinisë, shtetësisë, raportet e atësisë e amësisë, gjendjes civile, vdekjes, shpalljes së zhdukur, vendbanimit, vendqëndrimit dhe fakteve të tjera, të parashikuara me ligj (neni 6/1 Ligji për gjendjen civile). Mbiemri duhet të figurojë në disa akte themeltare të gjendjes civile të personit, si në aktin e lindjes (neni 42/2), aktin e martesës (neni 48) dhe është një përbërës që mund të ndryshojë (neni 8), sipas parashikimeve të Ligjit për gjendjen civile (Kreu IX) dhe Kodit të Familjes.

Kodi i Familjes (KF), parashikon të drejtën dhe marrëdhëniet familjare midis personave. Në interes të studimit do të shikohet vetëm aspektet që lidhen me barazinë midis bashkëshortëve⁵⁶ dhe përgjegjësinë prindërore, si dhe parashikimet e Kodit në lidhje me identitetin e fëmijëve të lindur brenda dhe jashtë martese dhe të birësuar.

Sipas parashikimit të nenit 1 KF martesa është një bashkëjetesë ligjore, e cila *«mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza e unitetit në familje»*. Në përforsim të parimit të barazisë, *«në martesë burri dhe gruaja përfitojnë të njëjtat të drejta dhe marrin përsipër të njëjtat detyrime»* (neni 50). Në lidhje me fëmijët, Kodi parashikon që *«çdo fëmijë, për një zhvillim të plotë dhe harmonik të personalitetit, ka të drejtë të rritet në një mjedis familjar, në një atmosferë gëzimi, dashurie dhe mirëkuptimi»* (neni 5) dhe për këtë, *«prindërit kanë detyrë dhe të drejtë të kujdesen për mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të lindur nga martesa ose jashtë martese»* (neni 3/1), duke pasur gjithmonë si konsideratë parësore *«interesin më të lartë të fëmijës»* (neni 2).

⁵⁵ Ligj 9062 datë 08.05.2003 “Për Kodin e Familjes”, i ndryshuar.

⁵⁶ Aspekte të zgjeruara të barazisë midis bashkëshortëve mund të shihen edhe në, Arta Mandro-Balili, “Diskriminimi gjinor në çështjet familjare e martesore”, Shkolla Magjistraturës, Tiranë, 2014.

Ndërsa, neni 215 KF parashikon përgjegjësinë prindërore duke përfshirë në të, «tërësinë e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tij». Kjo përgjegjësi, «u përket dhe ushtrohet së bashku nga të dy prindërit në lidhje me fëmijën e lindur gjatë martesës së tyre ose jashtë martese, nëse është njohur nga të dy prindërit». Gjithsesi, «në qoftë se prindërit nuk bien dakord për atë që kërkon interesi i fëmijës, ata mund t'i drejtohen gjykatës, e cila vendos pasi është përpjekur ta zgjidhë çështjen me pajtim».

Në lidhje me identitetin e bashkëshortëve si dhe të identitetit të fëmijëve, parë sidomos nga pikëpamja e mbiemrit të tyre por dhe të mbiemrit familjar, Kodi i Familjes bën parashikime të rëndësishme, por jo të detajuara.

Sipas nenit 51 KF (Mbiemri i bashkëshortit), «bashkëshortët, kur lidhin martesën, kanë të drejtë të zgjedhin për të mbajtur si mbiemër të përbashkët njërin nga mbiemrat e tyre ose të mbajnë secili mbiemrin e vet». Në kuptim të kësaj dispozite, familja mund të ketë si mbiemër të përbashkët njërin nga mbiemrat e bashkëshortëve, duke mos diskriminuar midis tyre, si dhe lejon që bashkëshortët të mos krijojnë një mbiemër të përbashkët për familjen por secili prej tyre të mund të mbajë mbiemrin e vet.

Legjislacioni shqiptar nuk lejon krijimin e një mbiemri familjar i cili mund të jetë ndryshe nga mbiemrat e bashkëshortëve, si dhe nuk lejon për mbiemër të përbashkët familjar mbajtjen e të dy mbiemrave njëherësh. Ligji rregullon çështjen e mbiemrit edhe në rastin e zgjidhjes së martesës duke parashikuar që «bashkëshorti që me lidhjen e martesës ka ndryshuar mbiemrin e tij, pas zgjidhjes së martesës merr mbiemrin që ka pasur para lidhjes së martesës». Lejohet përdorimi i mbiemrit të martesës nga bashkëshorti pas zgjidhjes së martesës, por vetëm me vendim gjykate kur kjo çmon se është në interes të bashkëshortit apo të fëmijëve (neni 14 KF).

Edhe pse neni 51 KF nuk bën dallime gjinore mbi vendosjen e mbiemrit të familjes dhe krijon kushtet që bashkëshortët të mbajnë mbiemrin e tyre para martese, sipas të dhënave zyrtare të marra nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGjC) vetëm në 2.84% të totalit të familjeve shqiptare⁵⁷, mbiemri i përbashkët i familjes është ai i gruas. Ndërsa, numri i familjeve ku bashkëshortët

⁵⁷ Numri total i familjeve shqiptare sipas RKGjC (të dhënat Maj 2023), është 974.497.

kanë mbajtur secili mbiemrin e vet para martesë është 10.67 % e totalit të familjeve.

Pavarësisht përqindjeve të ulëta, sidomos në rastet e mbiemrit të bashkëshortes si mbiemër të përbashkët familjar ku prevalenca e disbalancës gjinore është dominante, duhet thënë se në 20 vite hyrje në fuqi të Kodit aktual të Familjes, impakti ka qenë i konsiderueshëm nga aspekti gjinor referuar % së numrit të familjeve ku bashkëshortët ruajnë mbiemrin e tyre para martesë. Kjo tregon që në aspektin identitar të bashkëshortëve Kodi i Familjes ka filluar të konsolidojë efektet e tij në garantim të parimit të barazisë gjinore.⁵⁸ Nga ana tjetër, nevojitet të kuptohet nëse kjo qasje barazie garantohet edhe në lidhje me fëmijët.

Në lidhje me mbiemrin e fëmijëve, Kodi i Familjes bën parashikime për fëmijët brenda martesës, jashtë martesës dhe të birësuarit.

Në rastin e fëmijëve brenda martesës, sipas nenit 52 KF parimi kryesor është që «*fëmija merr mbiemrin e përbashkët të prindërve*». Parim tjetër kryesor është që fëmijët duhet të kenë të njëjtin mbiemër dhe kjo i referohet rasteve kur bashkëshortët kanë mbajtur secili mbiemrin e vet, pra kur prindërit kanë mbajtur mbiemra të ndryshëm. Parim i fundit kryesor është që sidomos në këto raste, bashkëshortët prindër duhet të vendosin nëpërmjet një marrëveshje mbiemrin e përbashkët që do të mbajnë fëmijët.

Siç u vu re nga standartet ndërkombëtare të mësipërme, marrëveshja midis bashkëshortëve shikohet si një nga mjetet më të mira dhe më të dëshiruara për të vendosur çështjet e mbiemrit të përbashkët familjar e sidomos mbiemrin e fëmijëve. Eventualisht, duhen mbajtur parasysh edhe ato raste kur midis bashkëshortëve nuk arrihet një marrëveshje për mbiemrin e fëmijëve. Kodi Familjes në këtë rast parashikon që «*kur marrëveshja nuk arrihet, fëmijët mbajnë mbiemrin e të atit*».⁵⁹

I njëjti parashikim në lidhje me vendosjen automatikisht të mbiemrit të babait në rast mosmarrëveshje midis prindërve, bëhet edhe për fëmijët e lindur jashtë martesë (neni 171 KF), si dhe për fëmijët e birësuar (neni 260 KF).

⁵⁸ Duhet mbajtur parasysh që parashikimi i nenit 51 KF është krejtësisht i ngjashëm me nenin 26 të Kodit të Familjes të vitit 1982, çfarë nënkupton që këto efekte nuk i atribuohen krejtësisht kodit aktual të familjes.

⁵⁹ Edhe parashikimi i nenit 52 KF është krejtësisht i ngjashëm me nenin 27 të Kodit të Familjes të vitit 1982.

Sipas këtij parashikimi është i dukshëm pozicioni prevalent që i është dhënë babait në lidhje me mbiemrin e fëmijëve dhe nuk duket të ketë një arsye objektive apo shkak të ligjshëm. Ky parashikim, vendoset në mospërputhje me parimin e barazisë gjinore sipas Kushtetutës, standarteve ndërkombëtare të evidentuara në Konventat për mbrojtjen e të drejtave të ratifikuara nga Shqipëria, si dhe me vetë parimet e Kodit të Familjes, sipas të cilit bashkëshortët duhet të jenë në pozita të barabarta në lidhje me çdo aspekt të martesës e sidomos prindërit në çdo aspekt që lidhet me fëmijët.

Problemi i këtij parashikimi qendron jo vetëm në faktin që ja atribuon automatikisht burrit vendosjen e mbiemrit për fëmijët në rast mosmarrëveshje, por edhe sepse nëpërmjet këtij parashikimi pozita e burrit dhe e gruas për arritjen e një marrëveshje nis në kushte të pabarabarta. Vendosja automatike e mbiemrit atëror është një instrument favorizues për burrin i cili as nuk e nxitet që të vendoset në kushte diskutimi në çështje që lidhen mbi mbiemrin e fëmijëve. Problematika paraqitet akoma më e mprehtë sidomos në rastet e fëmijëve të lindur jashtë martese, ku burimi i mosmarrëveshjes midis prindërve të fëmijës mund të jetë më i madh. (Shiko çështjen Leon Madrid kundër Spanjës)

Në këtë kuptim, edhe pse fryma e legjislacionit shqiptar priret drejt barazisë gjinore, akoma në brendësi të këtij legjislacioni evidentohet pabarazi të dukshme gjinore midis burrit dhe gruas, sidomos në marrëdhënie familjare që nuk marrin shpjegim tjetër përveç atij të ndikimit tradicionalist dhe patriarkalist të rolit të burrit në familje.

Këtë e bën akoma më të dukshëm fakti që, edhe pse në shumë raste të tjera që mund të përbëjnë burim mosmarrëveshje midis prindërve Kodi parashikon gjykatën si zgjidhëse të situatave, në rastin e mbiemrit të fëmijëve ku primar është interesi më i lartë i tyre, Kodi ka parashikuar një zgjidhje automatike *ex lege* e cila dukshëm favorizon gjininë më të avantazhuar në shoqëri, duke krijuar premisa të cenimit të barazisë nëpërmjet diskriminimit me bazë gjinore.

Sipas të dhënave të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile vetëm në 2% të familjeve ku bashkëshortët ka mbajtur mbiemrat e tyre para martese⁶⁰, mbiemri i fëmijëve ka qenë ai i nënës. Nëse do të marrim të mirëqenë që kjo shifër i referohet rasteve kur midis bashkëshortëve është arritur një marrëveshje për vendosje të mbiemrit të nënës si mbiemër të fëmijëve, kjo % rezulton shumë e

⁶⁰ Në total numri i këtyre familjeve është 104.046.


ulët. Ndërkohë, rezulton që në 47% të familjeve ku bashkëshortët kanë mbajtur mbiemrat e tyre para martesë, mbiemri i fëmijëve ka qenë ai i babait.⁶¹

2. Gjetjet e pyetësorit për çështjet në lidhje me mbiemrin

Në bazë të informacionit të administruar, nuk disponohen të dhëna mbi rastet e mosmarrëveshjeve midis bashkëshortëve për çështjet e mbiemrit por referuar pyetësorëve drejtuar administratës së gjendjes civile rezulton që:

- Në pyetjen, a keni pasur praktikë konkrete të marrëveshjes midis bashkëshortëve me mbiemra atë ndryshëm në lidhje me mbiemrin e fëmijës? (Pyetja Nr.15 në Pyetësorin 1) Ka rezultuar se gjatë veprimtarisë së administratës të gjendjes civile 30% e tyre kanë pasur praktika konkrete të marrëveshjes së bashkëshortëve për mbiemrin e fëmijëve.

15. A keni patur praktike konkrete të marrëveshjes midis bashkëshortëve për mbiemrin e fëmijëve?




Grafiku Nr. 1

- Lidhur me pyetjen se cila është forma juridike e marrëveshjes midis bashkëshortëve që kanë mbiemra të ndryshëm në lidhje me mbiemrin e fëmijës/fëmijëve? (Pyetja Nr.16 në Pyetësorin 1) Rezulton se në mbi 61% të rasteve marrëveshja është bërë me gojë ose ka qenë e nënkuptuar, 16%. Ndërkohë që 20% pretendojnë se është bërë edhe nëpërmjet formularit tip edhe pse nuk rezulton nga aktet nënligjore që të ekzistojë një formular i tillë. Dhe vetëm 3 % flasin për formë noteriale të kësaj marrëveshje.

⁶¹ Pjesa tjetër prej 51 %, prezumohet që janë familje që nuk kanë fëmijë në përbërjen e tyre.

16. Cila është forma juridike e marrëveshjes midis bashkëshortëve që kanë mbiemra të ndryshëm në lidhje me mbiemrin e fëmijës?



Grafiku Nr. 2

Edhe pse në përgjigjet e administratës së gjendjes civile rezulton se bashkëshortët kanë pasur dakordësi në rreth 70% të rasteve të trajtuara me marrëveshje, ky konsensus nuk duket të jetë i formësuar me një vullnet në forma juridike të qarta, por krijon më shumë përshtypjen e një vullneti të pranuar në bazë mendësie se sa informimi. Nga ana tjetër rezulton se ka pasur raste mosdakordësie (30%) të deklaruar në praktikën e gjendjes civile por nuk ekzistojnë evidenca mbi trajtimin juridik të këtyre rasteve.

Në përmbledhje të sa më sipër, rezulton që ka një prevalencë të dukshme të identitetit atëror mbi fëmijët, kundrejtë identitetit amësor të tyre në lidhje me mbiemrin. Kjo vjen si pasojë e parashikimeve ligjore të Kodit të Familjes por edhe e ndikimit të fortë të traditës patriarkale në vetë konceptimin e familjes nga shoqëria. Ndikimi i dispozitave ligjore në prevalencën e burrit është i dukshëm sidomos në rastet e mosmarrëveshjes midis prindërve me mbiemra të ndryshëm, ndërsa ndikimi i konceptimit patriarkal të familjes nga shoqëria është i dukshëm nga fakti që pavarësisht se Kodi i Familjes i njeh të drejta të barabarta bashkëshortëve në vendosjen e mbiemrit të përbashkët të familjes, në mbi 85% të familjeve shqiptare mbiemri i familjes është ai i burrit.

3. Në lidhje me identifikimin e personit në aktet administrative.

Në jetën e përditshme të gjithë qytetarët përballen me administratën dhe akte të ndryshme administrative të cilat dalin nga organet publike në lidhje me marrëdhënie konkrete dhe individuale. Mënyra kryesore dhe fillestare se si një person vendoset në kontakt me administratën për të bërë kërkesa, për të nisur procedura administrative, për të marrë akte administrative, është nëpërmjet identitetit të tij. Edhe pse si elementë përbërës të identitetit të personit Ligji për gjendjen civile parashikon një sërë elementësh të rëndësishëm, ku ndër të tjera përcaktohen edhe raportet e amësisë dhe atësisë, rezulton nga shumë akte nënligjore dhe në praktikën e administratës që identifikimi i personit të bëhet nëpërmjet emrit, atësisë dhe mbiemrit.

Për qëllim të studimit nuk do të merremi me legjisacionin që parashikon mënyrat se si vendoset atësia dhe mëmësia e personit. Këto parashikime janë të shtjelluara gjerësisht në dispozitat e Kodit të Familjes në Pjesën e Tretë, Titulli i Parë, emërtuar "*Amësia dhe Atësia*".

Vetë Ligji për gjendjen civile, referon Kodin e Familjes në lidhje me këto përbërës. Është në interesin e këtij studimi të shikohet nëse respektohet parimi i barazisë gjinore dhe ai midis prindërve në identifikimin e personit dhe implikimet e mundshme gjinore në zhvillimin e personalitetit të personit. Paraprakisht duhet thënë që përdoret gjerësisht si mënyrë identifikimi i personave, atribuimi vetëm dhe ekskluzivisht i elementit "atësi" duke mos pasur fare në vëmendje mëmësinë e personit.

Në raste të rralla është vetë ligji që parashikon atësinë si një element shtesë të identifikimit, por në pjesën më të madhe janë aktet nënligjore që e kërkojnë atësinë, sidomos nëpërmjet formularëve tip që vendosen për aspekte të ndryshme juridiko-administrative.

Në Kodin e Procedurës Civile, dispozitat që kërkojnë identifikimin e personit që lidhen me ngritjen e padisë, identifikimin e dëshmitarëve dhe personave të tretë, kërkon ekspresivisht përveç emrit dhe mbiemrit, vetëm atësinë (neni 154 KPrC). E njëjta kërkesë parashikohet edhe në nenin 158 KPrC në lidhje me veprimet paraprake të gjyqarit, si dhe neni 568 KPrC në lidhje me shpalljen e ankandeve.

Në pjesën më të madhe janë aktet nënligjore të ndryshme që për aplikime dhe në formularin tip, kërkojnë identifikimin e personit duke i shtuar emrit dhe mbiemrit edhe atësinë. Për efekt të këtij studimi janë marrë në konsideratë disa

akte nënligjore të ndryshme, por duhet thënë së ky parashikim përdoret gjerësisht në aktet nënligjore dhe ato administrative, si dhe nga subjektet private.

Si shembull sjellim në vëmendje disa akte të cilat nuk janë shteruese, pasi ndodhen me dhjetra në morinë e akteve nënligjore, por që kanë më shume qëllim ilustrimi:


- VKM Nr. 722, datë 11.11.2019, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, e ndryshuar. **(Shiko Aneks Nr. 1)**
- Udhëzim Nr. 66, datë 4.2.2021 “Për miratimin e formatit të regjistrimit për regjistrimin e dekretit për fitimin, rifitimin dhe lënien e shtetësisë shqiptare”. **(Shiko Aneks Nr. 2)**
- Udhëzim nr. 1, datë 8.1.2021, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të skemës së mbështetjes me naftë për bujqësinë”, i ndryshuar. **(Shiko Aneks Nr. 3)**
- VKM Nr.453, datë 3.7.2019, “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet, që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, i ndryshuar. **(Shiko Aneks Nr. 4)**
- Udhëzim Nr. 402, datë 14.5.2019 “Për procedurat e punësimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në republikën e shqipërisë nëpërmjet platformës elektronike”. **(Shiko Aneks Nr. 5)**
- Vendim Nr.68, datë 13.10.2010, i Bankës së Shqipërisë, Për miratimin e udhëzimit, “Për procedurën e nxjerrjes së raportit mbi kredimarrësin dhe rishikimin e të dhënave që mbahen në regjistrin e kredive”. **(Shiko Aneks Nr. 6)**

Është e dukshme prevalenca e përbërësit atësor të identitetit të personit duke injoruar dhe neglizhuar elementin amësor.

4. Gjetjet e pyetësorit në lidhje me indentitetin e personit

Në pyetjen 13 të Pyetësorit Nr.2, sipas të cilës: Në formularët/ modelet e kërkesave që qytetarët plotësojnë ose që i drejtohen institucionit tuaj, në përforcim të identifikimit të personit a kërkohet dhe atësia? – Përgjigja nga punonjës të administratës ka qenë PO në rreth 60% të rasteve.

13. Në formularët/ modelet e kërkesave që qytetarët plotësojnë ose që i drejtohen institucionit tuaj, në përforsim të identifikimit të personit a kërkohet dhe atësia?




Grafiku Nr. 3

Ndërsa, të pyetur (Pyetja 14 e pyetësorit 2): Në rastin kur kërkohet Atësia e personit në kërkesë ose për identifikim, ku mbështetet ajo? – Përgjigjet e punonjësve të administratës ka qenë: në ligjin specifik që parashikon shërbimin 28%; në aktin nënligjor përkatës 11%; në rregulloren e brendshme të institucionit 16%; ndërsa kanë pranuar mos praninë e një akti por praktikë të punës të kërkesës së atësisë, 45%.

Kjo përgjigje e fundit tregon shumë jo vetëm mbi ndikimin e akteve ligjore dhe nënligjore në këtë përcaktim, por sidomos në pranimin si të zakonshëm të identifikimit atëror si aspekt social normal të konceptit identifikues të personit. Po aq e rëndësishme, kjo shifër (45%) tregon edhe hapësirën që ekziston, pa patur nevojë për ndryshime ligjore, që të përfshihet amësia në identifikimin e personit. Ky ndryshim mund të vijë vetëm pasi drejtuesit e administratës të ndërgjegjësohen mbi efektet sociale që kanë veprimet administrative rolin që ato mund të luajnë në përforsimin e modeleve të reja të marrvdhënieve gjinore.


14. Në rastin kur kërkohet Atësia e personit në kërkesë ose për identifikim, ku mbështetet ajo?



Grafiku Nr. 4

Të pyetur nëse kërkojnë si mënyrë identifikimi të personit përveç Atësisë, edhe Amësinë? (Pyetja Nr.16 në Pyetësorin 2) – Përgjigjet e punonjësve të administratës kanë qenë JO-69%, PO-22% dhe 9% kanë konfirmuar që nuk e bëjnë pasi nuk parashikohet nga formulari tip.


16. A kërkonte si mënyrë identifikimi të personit përveç Atësisë, edhe Amësinë? Pra Emër, Atësi, Amësi, Mbiemër?



Grafiku Nr. 5

Të pyetur, në pyetjen pasuese nëse kanë kërkuar vetëm amësinë si mënyrë identifikimi krahas emrit dhe mbiemrit, përgjigjet kanë qenë JO-82% dhe 15% konfirmojnë që nuk e kanë bërë pasi nuk parashikohet në formularin tip.


17. A kërkoni si mënyrë identifikimi të përsosur të Amësinë? pra Emër Amësi Mbiemër?



Grafiku Nr. 6

Kjo mënyrë identifikimi nuk është e zakonshme vetëm në rastin e kërkesave të qytetarëve në kontakt me administratën, por rezultojnë edhe në vetë aktet që administrata nxjerr. Në pyetjen Nr.15 të Pyetësorit 2, sipas të cilës: A parashikohet vendosja e Atësisë edhe në aktin administrativ që institucioni nxjerr? – Përgjigjet e punonjësve të administratës ka qenë PO-54%, JO-23%.

15. A parashikohet vendosja e Atësisë edhe në aktin administrativ që institucioni nxjerr? Pra, Emër, Atësi, Mbiemër?



Grafiku Nr. 7

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar akteve që lidhen me regjistrimin e fëmijëve dhe të rinjve në arsimin parauniversitar dhe në IAL-të publike, duke

pasur parasysh impaktin e këtyre dokumentave në perceptimin e identifikimit të personit vetëm me figurën atërore. Për më tepër kjo mënyrë identifikimi shoqëron personin edhe në dokumentin që merret pas përfundimit të studimeve, në formën e dëftesës apo të diplomës së pjekurisë. Sjellim në vëmendje aktet nënligjore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit:

- Urdhër Nr. 31, datë 28.1.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”. **(Shiko Aneks Nr. 7)**
- Udhëzim Nr. 16, datë 8.7.2019 “Për pajisjen e institucioneve të arsimit të lartë me regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave”. **(Shiko Aneks Nr. 8)**
- Udhëzim Nr. 10, DATË 15.5.2019, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar. **(Shiko Aneks Nr. 9)**

Nuk ekziston një arsye ligjore apo juridike mbi këtë predominancë të atësisë në identifikimin e personit, përveç kuptimit tradicionalist të rolit të babait në familje dhe lidhjes së ngushtë të identifikimit të fëmijëve vetëm me babain dhe jo me nënën. Minimalisht, në këtë qasje është i dukshëm mosrespektimi i parimit të barazisë gjinore në konceptin kushtetues, konventor dhe ligjor duke i atribuar, si në rastin e mbiemrit, një tendencë fortësisht patriarkale të mënyrës së konceptimit të identifikimit të personit, si nga aktet nënligjore ashtu edhe nga praktika e administratës.

Si shembull, përmendet Udhëzimi Nr.10, datë 30.3.2020 “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, i cili parashikon aktin me të cilin pajisen studentët në përfundim të programit të tyre arsimor. Në pikën 1 shkronja ë) të këtij udhëzimi, parashikohet ndër elementet e tjera përbërëse të dokumentit Diplomë/Certifikatë, përcaktimi i identitetit të studentit. Sipas këtij parashikimi në Diplomë vendoset Emër Atësi Mbiemër.

Sipas informacioneve të marra na IAL të ndryshme publike në Shqipëri, rezulton se identifikimi i studentëve që nga regjistrimi i tyre e deri në përfundimin e ciklit të parë të studimit, bëhet vetëm nëpërmjet atësisë. Gjithashtu, edhe për ciklin e dytë të studimeve (Master) dhe të atyre Master Ekzekutiv dhe Doktorale,

identifikimi i personit si në regjistrim ashtu edhe në marrjen e dokumentit e përfundimit të studimeve bëhet vetëm nëpërmjet atësisë.

Edhe informacioni identifikues i studentëve që vjen na institucionet e arsimit parauniversitar, përcaktohet vetëm më atësinë. Rezulton që vetëm në disa akte të brendshme të arsimit parauniversitar që janë mbajtja e numrit të Amzës dhe Regjistri i klasës, përcaktohen të dy prindërit e nxënësit (Shiko Udhëzim nr.28 datë 2/8/2013 “Për pajisjen e nxënësve me dëftesë klase”). Gjithsesi, pavarësisht se në këto akte të brendshme themeltare fëmija identifikohet me atësinë dhe mëmësinë, në dëftesat dhe diplomat që institucionet e arsimit parauniversitar lëshojnë, identifikimi bëhet vetëm nëpërmjet atësisë. Praktikisht këto janë aktet që dëshmojnë për çdo person mbarimin e cikleve të arsimit parauniversitar de e shoqërojnë atë për gjithë jetën. **(Shiko Aneks Nr.10)**

Nga hulumtimi i bërë rezulton se janë shumë akte nënligjore të organeve publike që kërkojnë atësinë si element shtesë identifikimi dhe kjo gjë është përcuar edhe në shumë subjekte private që administrojnë të dhëna identifikuese të personit. Gjithashtu, edhe në ato raste kur nuk ka një akt nënligjor që ta kërkojë atësinë ekspresivisht si përbërës identifikimi, praktika e administratës gjithsesi e kërkon. Për më tepër, vendosja e këtij elementi shtesë rezulton i tepërt edhe për faktin që tashmë çdo individ ka numrin e vet personal të identifikimit.

Ligjërisht nuk ka asnjë bazë kërkimi i vetëm këtij elementi shtesë për identifikimin e personit, pavarësisht se e gjejmë në shumë aktë nënligjore. Nga ana tjetër, impakti që ka kërkimi i vetëm këtij elementi për identifikimin e personit dhe vendosja e vetëm këtij elementi në shumë akte të natyrës administrative përfshi dhe ato të arsimit, është i konsiderueshëm sidomos në mbajtjen gjallë të perceptimit patriarkal të familjes dhe të identitetit të personit, dhe për rrjedhojë të përforcimit të pabarazisë gjinore në shoqërinë shqiptare.

5. Përmbledhje paraprake e gjetjeve

Bazuar në gjithë sa më sipër si dhe analizën e pyetësorëve, dallohet qartësisht se jemi përballë një situatë ku atësia është theksuar dhe e preferuar ndaj amësisë në dokumentacionin zyrtar dhe praktikat administrative, gjë e cila ndikon në perceptimin e identitetit të personit.

Për shkak të kësaj përqsajeje ndaj atësisë dhe minimalizimit të amësisë, dalin disa çështje si më poshtë:

- Prevalenca e atësisë: Në përgjigjet e pyetësorit, është evidentuar se atësia kërkohet më shumë në dokumentacionin dhe praktikën administrative se sa amësia. Kjo prevalencë është kryesisht e bazuar në praktikën administrative – traditën e të bërit të gjërve ndër vite – dhe jo detyrime ligjore specifike. Vazhdimi i kësaj tradite thekson lidhjen e identitetit të fëmijëve ekskluzivisht me babain përkundrejt nënës.
- Mospranimi i amësisë si mënyrë ekuivalente e identifikimit: Administrata dhe institucionet kanë ndikuar në mospranimin e amësisë si një mënyrë ekuivalente e identifikimit, edhe pse në disa raste ajo është e mundshme dhe e rëndësishme. Kjo gjithashtu, në tërësi, është produkt i praktikës së administratës.
- Prevalenca e atësisë si dhe mos pranimi i amësisë si formë e njejtë identifikimi kanë përforcuar paradigmat patriarkale të pabarazisë gjinore. Kjo situatë duket se ndikon në një perceptim tradicionalist të rolit të babait dhe në ndarjen e përgjegjësisë së identifikimit me atësinë.
- Gjthë sa më sipër krijon pengesa për arritjen e barazisë gjinore efektive në shoqërinë shqiptare. Në tërësi, përqasja ndaj atësisë në identifikim ndikon në një perceptim të padrejtë të identitetit të personit, nxit pabarazinë dhe mban gjallë një perceptim patriarkal të shoqërisë.

Gjithësesi, në të dhenat e gjeneruara nga ky studim ka dhe një pikë pozitive e të rëndësishme për të ardhmen. Në thuajse gjysmat e rasteve të praktikave administrative, atësia kërkohet si instrument identifikimi bazuar në traditën administrative dhe jo kërkesa apo detyrime ligjore. Kjo mund të jetë edhe pika ku në të ardhmen mund të bazohemi për të ndryshuar situatën. Nëpërmjet edukimit gjinor, mund të identifikohen këto praktika – sidomos në nivel vendor – dhe të ndryshohen. Kësisoj mund të fillojë edhe ndryshimi i perceptimit të identitetit të fëmijëve si ekskluzivisht i lidhur me babain. Këto ndryshime në nivel vendor më pas mund të shërbejnë si shembull apo pikënisje për një ndryshim më të fortë në nivel qendror.

III. Mbi konceptin e Kryefamiljarit

Edhe pse parashikimet ligjore, sidomos të Kodit të Familjes, dhe fryma e Kushtetutës dhe konventave shkojnë drejt një kuptimi thelbësor të barazisë gjinore midis bashkëshortëve, në rendin juridik shqiptar gjen një parashikim të gjerë koncepti i Kryefamiljarit, sidomos në aktet nënligjore. Referencë ligjore në lidhje me këtë koncept edhe pse jo me qëllim përkufizimi, gjejmë në Ligjin për Gjendjen Civile. Neni 16 i Ligjit për Gjendjen Civile (E drejta për deklarin e vendbanimit), parashikon që «*deklarimin e vendbanimit apo të banesës për pjesëtarët e një familjeje ka të drejtë ta bëjë kryefamiljari ose, në pamundësi të tij, çdo person madhor i familjes*». Sipas kësaj dispozite (paragrafi 3), të miturit kanë vendbanim atë të Kryefamiljarit, si dhe sipas nenit 17 të Ligjit për Gjendjen Civile, kur një familje banon në vendbanimin e një familje tjetër janë Kryefamiljarët ato që bashkërisht bëjnë deklarin duke «*...shprehur vullnetin e tyre për këtë qëllim para nëpunësit të zyrës së gjendjes civile, në juridiksionin e së cilës është vendbanimi i familjes pritëse*».

Siç shihet, parashikimi i konceptit të kryefamiljarit në këtë Ligj është sporadik dhe i përgjigjet vetëm një aspekti të familjes, atë të deklarin të vendbanimit. Në lidhje me vendbanimin fryma e konventave por edhe e Kodit të Familjes është që ai të vendoset bashkërisht midis bashkëshortëve. Kështu, sipas nenit 55 të Kodit të Familjes, «*vendbanimi i familjes është vendi që bashkëshortët zgjedhin me marrëveshje të përbashkët*», duke parashikuar gjykatën si zgjidhëse të situatës në rastin kur bashkëshortët nuk dakordësojnë në lidhje me vendbanimin. Në këtë kuptim, atribuimi i të drejtës së deklarin të vendbanimit vetëm Kryefamiljarit, duket se e vendos në kontradiktë Ligjin për Gjendjen Civile me Kodin e Familjes.

Nga ana tjetër, edhe pse në Ligjin për Gjendjen Civile Kryefamiljari nuk përkufizohet e as nuk parashikohet në ndonjë nga aktet e gjendjes civile, këtë koncept e gjejmë përcaktues në një nga aktet më të rëndësishme të gjendjes civile siç është certifikata familjare. Sipas VKM Nr.332, datë 17.3.2010 “Për përcaktimin e formës, elementeve përbërëse, mënyrës së mbajtjes e afatit të përdorimit të dokumenteve bazë, që mbahen dhe lëshohen nga shërbimi i gjendjes civile”, i ndryshuar, në Modulet 13 dhe 13/1 përcaktohet forma dhe përmbajtja e certifikatës familjare. **(Shiko Aneks Nr.11)**

Sipas këtij modeli që është ideuar në bazë renditje numerike, në certifikatën familjare vendosen Lista Numerike/ Emri dhe Mbiemri/ Emri i Babait/ Emri i Nënës/ Gjinia/ **Lidhja me Kryefamiljarin/** Datëlindja/ Gjendja Civile/

Vendlindja/ Shtetësia/ Numri Personal. Nëse të gjithë përbërësit e certifikatës kanë parashikim ligjor dhe lidhen me aspekte të identifikimit të personit vetëm përbërsi “Lidhja me Kryefamiljarin”, nuk gjen bazë juridike.

Nisur nga parashikimet juridike që Kodi i Familjes bën për familjen dhe bashkëshortët, të cilët i vendos krejtësisht në pozita barazie, koncepti i kryefamiljarit shkon direkt në kontradiktë dhe mospërputhje jo vetëm me Kodin e Familjes por me parimin e barazisë në vetvete dhe sidomos me parimin e barazisë gjinore.

Kështu, pavarësisht se parashikimi i Kryefamiljarit si koncept është i shkëputur nga përkatësia gjinore (edhe pse parashikimi i termit në gjininë mashkullore ka një relevancë në vetvete), rezulton që vetëm në 0.41% të familjeve shqiptare që i kanë të dy bashkëshortët, Kryefamiljarja është grua.⁶² Ndërsa, duke ju referuar të dhënave të vitit 2022 vetëm në 2.4% të familjeve shqiptare kryefamiljarja është grua, duke përfshirë edhe familjet ku gruaja është kryefamiljare e vetme.⁶³

Është e dukshme që një koncept i cili në vetvete nuk gëzon një bazë të fortë juridike ekzistenciale, por që gjen terren të gjerë në aktet normative jo vetëm të gjendjes civile por dhe të përfitimeve të ndryshme, mbështetet kryesisht në pabarazinë e dikurshme gjinore midis bashkëshortëve e cila lidhet me trashëgiminë kulturore, tradicionale, patriarkale të shoqërisë shqiptare.⁶⁴ Ndikimi i këtyre faktorëve mbetet i fortë si në aspektin normativ, në atë shoqëror e për rrjedhojë edhe në veprimtarinë e administratës.

Në aspektin normativ, interesant për tu përmendur është Ligji Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i cili në nenin 16 (Aplikimi dhe përfitimi i ndihmës ekonomike), paragrafi 5 parashikon që «të drejtën për ta tërhequr dhe marrë në dorëzim ndihmën ekonomike për familjet në nevojë e ka bashkëshortja e kryefamiljarit», duke i dhënë në këtë mënyrë kuptim gjinor Kryefamiljarit si përherë mashkulli. Në vazhdim, dispozita insiston të thotë që

⁶² Nga 974.697 familje që i kanë të dy bashkëshortët në total deri në muajin Maj të vitit 2023, vetëm në 4.020 familje kryefamiljarja është grua.

⁶³ Në Maj të vitit 2022, numri total i familjeve rezultonte 942.101, ndërsa numri i familjeve me kryefamiljare grua 22.718.

⁶⁴ Mbi aspektet gjinore dhe rolin dominues të burrit të lidhur ngushtësisht me traditat dhe aspektin kulturor patriarkal referohet Raporti i tretë periodik për Shqipërinë i Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Gruas, viti 2008. (Përkthimi në shqip në gjuhë, link në anglisht:

<https://www.refworld.org/publisher,CEDAW,,ALB,4a646c080,0.html>

Gjithashtu, mbi të njëjtat aspekte, Arta Mandro-Balili, “Diskriminimi gjinor në çështjet familjare e martesore”, Shkolla Magjistraturës, Tiranë, 2014.

«për rastet kur në strukturën e familjes bashkëshortja mungon, të drejtën e tërheqjes e ka kryetari i familjes», duke nënkuptuar në këtë mënyrë burrin.

Në aspektin shoqëror, është i dukshëm fakti që edhe pse në të vërtetë nuk ka përcaktime gjinore në atribuimin e Kryefamiljarit dhe në parim mund të zgjidhet lirisht midis burrit dhe gruas, rezulton gjithsesi, që në 99% të familjeve shqiptare Kryefamiljar është burri.

1. Efektet ekonomike të përdorimit të konceptit të kryefamiljarit

Koncepti i Kryefamiljarit nuk ka rëndësi vetëm formale në aspektin e përbërjes familjare me gjithë implikimin gjinor të sipërpërmëtur, por ai lidhet dhe me shumë pagesa apo të drejta ligjore që parashikohen në akte të ndryshme ligjore dhe nënligjore.

Kështu, në Ligjin Nr.10 418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, i cili parashikon *«faljen e një pjese të borxhit tatimor e doganor, kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe kompetencat e organeve të administratave tatimore e doganore, të cilat evidentojnë tatimpaguesit/debitorët që përfitojnë nga ky ligj»*, ndër të tjera parashikon edhe nenin 29 (Falja e detyrimeve të papaguara të energjisë elektrike). Sipas kësaj dispozite, falen detyrimet e prapambetura për energjinë elektrike, të faturuar dhe të papaguar deri më 31 dhjetor 2006 dhe kamatëvonesat e përlllogaritura nga mospagesa e faturave të përmendura, ndaj shoqërisë KESH, sh. a. nga debitorët familjarë të përcaktuar në këtë nen, që janë:

- a) **kryefamiljarët** e familjeve që përfitojnë pagesën e ndihmës ekonomike;
- b) familjet që kanë në përbërje anëtarë me aftësi të kufizuara, të verbër, paraplegjikë ose tetraplegjikë, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të komisioneve mjekësore të posaçme dhe që përfitojnë pagesë aftësie të kufizuar, **kur personi është kryefamiljar** dhe nuk ka anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik a privat ose të vetëpunësuar në sektorin privat;
- c) **kryefamiljarët** që përfitojnë pagesë papunësie dhe që nuk kanë të ardhura të tjera;
- ç) **kryefamiljarët** që përfitojnë pension pleqërie dhe jetojnë të vetëm ose kanë fëmijë në ngarkim, të cilët janë pa të ardhura dhe janë të papunë;
- d) **kryefamiljarët** që përfitojnë pension, për të gjitha kategoritë, si dhe përfituesit me trajtim të veçantë, që kanë masë përfitimi më të vogël se të ardhurat minimale që përfitojnë pensionistët, të cilët janë pa të ardhura të tjera;

- dh) **kryefamiljarët** që përfitojnë pension invaliditeti dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik a privat ose nuk janë të vetëpunësuar;
- e) gratë kryefamiljare;
- ë) të gjithë personat kryefamiljarë që gëzojnë statusin e jetimit.

Në kuptim të këtij ligji kanë përfituar faljen e detyrimeve në lidhje me energjinë elektrike vetëm ato familje Kryefamiljarët e të cilave kanë pasur statusin që dispozita parashikon. Për rrjedhojë, në të gjitha rastet kur bashkëshortja ka pasur statusin e kërkuar por që në certifikatën e familjes nuk ka qenë kryefamiljare, falja nuk është përfituar.

Të njejtat parashikime bëhen edhe në VKM Nr. 8, datë 14.1.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 këh në muaj”, për rrjedhojë edhe Udhëzim Nr. 1, datë 2.2.2015 “Mbi zbatimin e Vendimit nr. 8, datë 14.1.2015 të Këshillit të Ministrave për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga heqja e fashës deri në 300 kwh për faturimin e çmimit të energjisë elektrike”. Parashikime që lidhen me kryefamiljarin bëhen në shumë akte të ndryshme (për shembull) që lidhen me të drejta pronësore, VKM Nr. 319, datë 18.5.2022 “Për kalimin te bashkitë shijak, kamzë, kavajë dhe krugë të njërive individuale të banimit”; përfitime sociale, VKM Nr. 474, datë 30.7.2021 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 486, datë 17.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar”, VKM Nr.159, datë 12.3.2022 “Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për zbutjen e efekteve të ndikuara nga lufta në Ukrainë”. **(Shiko Aneks Nr.12)**⁶⁵

Aq e fortë është lidhja e kryefamiljarit me burrin sa në një ligj shumë të rëndësishëm siç është ai Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Sqipërisë”, i cili «përcakton rregullat dhe mekanizmat për përfitimin e asistencës sociale, autoritetet përgjegjëse për garantimin e kësaj të drejte, si dhe marrëdhëniet e financimit të ofrimit dhe përfitimit të asistencës sociale», bëhet një përpjekje për përkufizimin e Kryefamiljarit. Sipas këtij ligji në nenin 4 shkronja h) përcaktohet që Kryefamiljar «është personi i parë sipas renditjes në certifikatën familjare», duke u bërë nga rastet e rralla që parashikimi ligjor të gjejë mbështetjen e vet juridike në një akt nënligjor. Me interes për tu përmendur


⁶⁵ Në këtë Aneks është vendosur një tabelë me pjesën më të madhe të akteve normative ligjore dhe nënligjore ku është evidentuar termi “kryefamiljar”, sipas të dhënave të marra në faqen zyrtare <https://qbz.gov.al/>

në këtë ligj është edhe koncepti i Kryetarit të Familjes, si sinonim i ndërshtëmblyeshëm me atë të Kryefamiljarit.

2. Gjetjet nga pyetësoret për çështjen e kryefamiljarit

Në aspektin e praktikës administrative, shikohen të dhëna interesante nga përgjigjet e punonjësve të gjendjes civile. Kështu, lidhur me pyetjen në bazë të cilit akti juridik bazoheni në përcaktimin e një Kryetari/e Familje apo Kryefamiljari/e në certifikatën familjare (Pyetja Nr.11 në Pyetësorin 1), rreth 98% përgjigjen që e mbështesin atë në Ligjin për gjendjen Civile, pavarësisht se ky ligj nuk e përcakton atë si përbërës të akteve të gjendjes civile. Lidhur me pyetjen nëse në bazë të praktikës tuaj, a pyeten bashkëshortët e një familje cili/a do të jetë Kryefamiljari/ja, (Pyetja Nr.12 në Pyetësorin 1) përgjigjet kanë qenë si më poshtë:

12. Në baze të praktikës tuaj, a pyeten bashkeshortet e një familje cili/a do të jetë Kryefamiljari/ja?




Grafiku

Nr. 8

Lidhur me pyetjen se çfarë kriteresh ndiqen në përcaktimin e nr.1 në renditjen e personave të një familje në përbërjen e certifikatës familjare? Duke vendosur si opsione kriterin gjinor, moshor, social, ekonomik ose tjetër (Pyetja Nr.13 në Pyetësorin 1). Përgjigjet kanë qenë si më poshtë:

13. Cfarë kriteresh ndiqen në përcaktimin e Nr.1 në renditjen e personave të një familje në përberjen e certifikatës familjare?



Nr. 9

Nga përgjigjet, rezulton se kryesisht procesi administrativ i përcaktimit të Kryefamiljarit është një proces i automatizuar dhe vetëm në 30% të rasteve bashkëshortët pyeten mbi dëshirën e tyre për të përcaktuar kryefamiljarin. Kjo do të thotë që kryesisht në përcaktimin e Kryefamiljarit ndikon aspekti shoqëror fortësisht patriarkal duke bërë që automatikisht ky rol t'i jepet burrit. Edhe pse nga përgjigjet në grafikun nr.9 duket sikur kriteri gjinor nuk përbën një % të lartë në përcaktimin e burrit si kryefamiljar, dhe është kriteri i moshës i cili më shumë ndikon në këtë përcaktim 51%, gjithsesi rezultat final mbetet fakti që kryefamiljari në një familje midis të barabartëve është gjithmonë burri. Gjithashtu në Shqipëri burri është kryesisht më i madh në moshë se gruaja duke e bërë kriterin moshor një mënyrë të tërthortë për të zgjedhur burrin si kryefamiljar.

3. Përmbledhje paraprake e gjetjeve

Analiza e mësipërme për përdorimin e konceptit të kryefamiljarit në aktet ligjore dhe ndikimin e tij në barazinë gjinore tregon se ndonëse nuk është përcaktuar në mënyrë të qartë si një pozitë e prerogativës së burrit, në praktikë shpesh lidhet me një perceptim të pabarabartë të rolit gjinor. Në shumicën e rasteve Kryefamiljar është burri, ndonëse ka parashikime ligjore që i vendosin në mënyrë të barabartë bashkëshortët midis tyre

Përdorimi i konceptit të kryefamiljarit ka pasur ndikim në praktika të ndryshme ligjore dhe nënligjore, si përfitime sociale, falje të detyrimeve, të drejta pronësore, etj. Përdorimi i këtij koncepti ka përcaktuar se kush ka të drejtën të

përfitojë nga këto përfitime dhe si, dhe ky përcaktim ka pasur përmasa gjinore. Përdorimi i konceptit të kryefamiljarit shpesh rezulton në një pabarazi gjinore është i kundërshtueshëm me zhvillimet e fundit në drejtim të barazisë gjinore dhe lirive të individëve.

Gjithësesi, dhe po aq e rëndësishme, siç e theksuam edhe më sipër, përcaktimi thuhetse-automatik i burrit si kryefamiljar bazohet në praktikë administrative dhe jo kërkesa apo detyrime ligjore. Kësisoj kjo praktikë mund të korrigjohet me edukimin apo trajnimin e administratës së gjendjes civile që përcaktimin e kryefamiljarit të mos e bëj automatikisht por të informojë palët që kanë të drejtë ta zgjedhin vetë.

IV. Përfundime dhe Rekomandime

1. Përfundime

Parimi i barazisë gjinore është në përpjekje të vazhdueshme për të konsoliduar kuptimin e tij formal nëpërmjet garantimit të barazisë thelbësore. Janë një sërë ndërhyrjesh të njëkohëshme të Shtetit Shqiptar në shumë fusha të jetës për të jetësuar thelbësisht barazinë gjinore midis burrave dhe grave.

Këto ndërhyrje i shikojmë në aspektin juridik që me Kushtetutën e Shqipërisë, ratifikimin e Konventave të rëndësishme për të drejtat e njeriut, ligjeve të ndryshme me karakter social ku gjithmonë barazia gjinore merr vëmendje të veçantë, por edhe strategjive⁶⁶ dhe një sërë aktësh nënligjore të cilat tregojnë qartë vullnetin e Shqipërisë për garantimin e kësaj barazie.

Ndërhyrje të rëndësishme vërehen edhe në marrjen e masave pozitive të përkohëshme me qëllim arritjen e barazisë gjinore, në aspektin politik, zgjedhjet për organet vendimarrëse, emërimet në institucione publike e gjithashtu, në aspektin ekonomik me masa të ndryshme për zbehjen e pabarazisë gjinore.

Edhe në të drejtën familjare, legjislacioni shqiptar paraqitet në pjesën më të madhe në linjë me parimet kushtetuese dhe të drejtat konventore, paçka se evidentohen disa aspekte ndërhyrëse të cilat do të rekomandohen më poshtë.

Gjithsesi, me gjithë ndërhyrjet e shumëfishta në pothuajse çdo fushë të jetës për arritjen e një barazie të vërtetë gjinore, problemet dhe sfidat mbeten të mëdha,⁶⁷ - ku disa nga më të mprehtat dhe domethënëse janë dhuna në familje,⁶⁸ aspektet ekonomike, të drejtat pronësore⁶⁹ - dhe efektiviteti i ndërhyrjeve has në rezistencë në momentin implementues të tyre.

⁶⁶ Aktualisht Shqipëria me VKM Nr.400 datë 30/06/2021 ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030.

https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/WEB_Strategjia-Kombetare-AL.pdf

⁶⁷ Për një panoramë të gjerë të situatës së barazisë gjinore në Shqipëri referohen Raportet Periodike III, IV, V të CEDAW për Shqipërinë.

⁶⁸ Në lidhje me aspekte që lidhen me dhunën në familje, referohet: Raporti i GREVIO-s për Shqipërinë miratuar në datë 12/10/2017. GREVIO/Inf(2017)13

<https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2020/07/Raporti-GREVIO.pdf>

⁶⁹ Si një studim i thelluar mbi të drejtat pronësore dhe implikimet gjinore por edhe mbi problematikat konkrete që koncepti i Kryefamiljarit reflekton në ushtrimin e këtyre të drejtave, referohet:

“Të drejtat pronësore të grave në Shqipëri: analizë e standarteve ligjore dhe e zbatimit të tyre në praktikë.”, UN Women, Tiranë, 2016.

Kjo rezistencë i ka rrënjët në aspektin kulturor dhe social shqiptar i cili zbeh efektshmërinë e ligjeve dhe efektivitetin e implementimit të politikave të ndryshme që ndërmerren. Janë ndikimet e ndryshme në këtë aspekt kulturor që kryesisht identifikohen me reflektimet patriarkale të perceptimit gjinor dhe roleve sociale të burrit dhe gruas.⁷⁰

Në këtë kuptim, implementimi i politikave të drejta gjinore kërkon edhe një ambjent shoqëror të ndryshëm mbi të drejtat e njeriut dhe të gatshëm për rikonsiderimin e konceptimeve të vjetra mbi rolet gjinore. Aktet normative dhe sjellja e administratës kanë një rol thelbësor në krijimin e këtij ambjenti dhe për këtë arsye nevojitet në radhë të parë, që ndikimi patriarkalist i kuptimit të familjes dhe i pozicionit të burrit dhe të gruas, të çrrënjoset pikërisht aty.

Siç edhe u evidentua nga kapitujt e mësipërm dhe duke marrë në konsideratë edhe standartet e vendosura prej vitesh nga Kombet e Bashkuara dhe Këshilli i Europës, legjislacioni shqiptar vazhdon akoma të ushqejë pabarazi gjinore midis gruas edhe burrit, duke i lënë këtij të fundit akoma një pozicion superior në familje sidomos në lidhje me identitetin personal të fëmijëve.

Edhe pse koncepti i Kryefamiljarit është i ndryshëm dhe më i zbutur se ai i Kryetarit të Familjes, gjithsesi vazhdon të mbajë në jetë një figurë të vetme si më të rëndësishme në familje në krahasim me të gjithë pjesëtarët e tjerë, dhe që në pjesën me të madhe të familjeve shqiptare përkon me figurën e burrit. Ky pozicion superioriteti nuk ka vetëm valencë sociale por edhe juridike pasi për përfitimin e shumë mbështetjeve sociale që jepen nga shteti, është kryefamiljari dhe statusi i tij që parashikohet në akte ligjore dhe nënligjore.

Ky parashikim, mbetje e traditës dhe të drejtës zakonore shqiptare, bie në kundërshtim të drejtëpërdrejtë me parashikimet e Kodit të Familjes sipas të cilit: «*martesa, si një bashkëjetesë ligjore, mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve*». Nëse baza e unitetit të familjes është pikërisht kjo barazi midis bashkëshortëve, atëhere pasja e një kryetari që për më tepër reflekton një disbalancë të theksuar gjinore e cenon këtë unitet.

Ky superioritet i mashkullit në familje reflektohet edhe në një nga arsyet ekzistenciale më thelbësore të familjes që është zhvillimi i personalitetit të

⁷⁰ Mbi mbajtjen e stereotipeve gjinore, aspektin patriarkalist, rolet gjinore dhe diskriminimin de facto të grave në shoqërinë shqiptare si pasojë e këtyre fenomeneve, referohet Raporti i III Periodik i CEDAW mbi Shqipërinë.

fëmijëve, për të cilin njëri nga aspektet me kryesore është identiteti i personit të tyre.

Sidomos në lidhje me identitetin personal, në të cilën emri përbën elementin e parë dhe më të menjëhershëm karakterizues, ai lidhet direkt me zhvillimin e personalitetit të personit, sidomos fëmijës. Kjo e drejtë kërkon që të garantohet brenda kuadrit të atij formacioni telbësor shoqëror që është familja, në drejtim të dyfishtë të së drejtës së nënës për t'ia kaluar mbiemrin fëmijës së saj dhe atë të fëmijës të marrë shenja identifikimi nga të dy prindërit, që dëshmojnë vazhdimësinë të historisë së tij familjare edhe në lidhje me linjën e nënës.⁷¹

Vlera e identitetit të personit, në plotësinë dhe kompleksitetin e shprehjeve të tij, dhe ndërgjegjësimi për vlerën publike dhe private të së drejtës për një emër si moment i shfaqjes të përkatësisë së individit në një grup familjar, gjejnë në kriteret e atribuimit të mbiemrit tek të miturit përcaktimin e identitetit të tij personal, i cili projektohet në personalitetin e tij shoqëror.⁷²

Edhe pse Kodi i Familjes ka një parashikim adekuat persa i përket barazisë midis bashkëshortëve, duke i lejuar ato që të mbajë secili mbiemrin e vet pas martesë, ky parashikim rezulton jo në përputhje me Kushtetutën dhe standartet ndërkombëtare kur momenti vjen tek mbiemri i fëmijëve.

Paraprakisht duhet thënë që legjislatori shqiptar i pas komunizmit nuk ka bërë asnjë risi për sa i përket çështjeve të mbiemrit, pasi ka mbajtur në përmbajtje identitike dispozitat e Kodit të Familjes të vitit 1982. Dispozitat ligjore të Kodit aktual të familjes paraqesin dy mangësi, të cilat të ndërthuruara me mendësinë patriarkale mbajnë akoma prevalent identitetin e babait mbi fëmijët.

Mangësia e parë lidhet me faktin që Kodi i Familjes nuk parashikon mundësinë që familja si mbiemër të përbashkët të ketë bashkësinë e të dy mbiemrave të bashkëshortëve. Kjo pamundësi bën që familja mund të ketë vetëm njërin nga mbiemrat e bashkëshortëve pa diskriminim. Gjithsesi, siç edhe u evidentua më sipër, me prevalencë absolute në familjet shqiptare vendoset mbiemri i burrit, për rrjedhojë edhe fëmijët mbartin vetëm këtë mbiemër.

Kjo mangësi, nuk është vetëm shqiptare, por ka qenë prevalente në shumë shtete si Italia, Turqia, Spanja, etj. Gjithsesi, rezulton që në një pjesë të konsiderueshme të shteteve anëtare të Këshillit të Europës, të jenë bërë ndryshime legjislative ku

⁷¹ Vendimi 61/2006 i Gjykatës Kushtetuese Italiane

⁷² Vendimi 286/2016 i Gjykatës Kushtetuese Italiane.

tashmë parashikohet mundësia e mbajtjes së të dy mbiembrave të bashkëshortëve si mbiemër të përbashkët të familjes. Vlen për tu theksuar që në pjesën më të madhe të këtyre vendeve, të cilat të gjitha vijnë nga e njehta mendësi patriarkale, nevoja e këtyre ndryshimeve kryesisht lidhet me identitetin e fëmijëve e sidomos të reflektimit të identitetit amësor, me qëllim zhvillimin e plotë të personalitetit të tyre e për rrjedhojë garantimin e interesit më të lartë. Gjithsesi, edhe GJEDNJ e ka konsideruar si një nga instrumentat më të përshtatshëm për të garantuar barazinë gjinore të prindërve në identitetin personal të fëmijëve të tyre.

Mangësia tjetër lidhet me faktin që vetëm për çështjen që lidhet me mbiemrin e fëmijëve kur bashkëshortët me mbiemra të ndryshëm nuk janë dakord, Kodi i Familjes nuk ofron një zgjidhje gjyqsore por mban parashikimin e Kodit të mëparshëm duke e zgjidhur çështjen *ex lege* në favor të babait.

Ky parashikim i vendos dukshëm prindërit në pozicion të pabarabartë dhe është një pabarazi që mbështetet vetëm në terma gjinorë, duke rezultuar krejtësisht diskriminues kundrejtë gruas në shkelje jo vetëm të Kushtetutës dhe Konventave ndërkombëtare por dhe të vetë parashikimeve të Kodit të Familjes.

Na ana tjetër, në këtë parashikim, është krejtësisht i dukshëm ndikimi i mendësisë patriarkale, sidomos në lidhje me trashëgimin e identitetit atëror nga fëmijët.

Kjo mendësi, në lidhje me këtë identitet, përforcohet duke vazhduar të ushqejë vetveten, në parashikimin krejtësisht unik shqiptar të vendosjes së atësisë në dokumenta të ndryshëm administrativë shtetërorë zyrtarë. Pavarësisht se tashmë çdo person ka numrin e vet personal unik dhe elementët identifikues japin garanci për identifikimin e personit, në një mori aktesh nënligjore kërkohet gjithmonë atësia për identifikimin e personit.

Të gjithë këto elementë sëbashku: prevalenca e figurës së burrit në familje, identifikimi i familjes me mbiemrin e burrit dhe shoqërimi i identifikimit të personit me emrin e babait, dukshëm krijojnë një disbalancë gjinore duke mbajtur të fortë stereotipet e roleve gjinore si dhe duke eliminuar krejtësisht reflektimin e identitetit mëmësor të personit.

Kjo qasje diskriminuese kundrejt gruas në pozicionin e saj në familje dhe perceptimin e këtij pozicioni, nëpërmjet aktesh normative, sjellje të administratës dhe konteksti shoqëror, mban të ngritura barriera gjinore, projekton të paplotë

identitetin e fëmijëve dhe zhvillimin e personalitetit të tyre, si dhe gjeneron pasoja të rënda deri në cenimin e të drejtës së jetës për shkak të abortit selektiv.⁷³

2. Rekomandime

Me qëllim arritjen e një barazie efektive midis burrit dhe gruas duke shmangur parashikimet dhe sjelljet diskriminuuese, si dhe reflektimin e standarteve më të mira ndërkombëtare për të realizuar të plotë identitetin e fëmijëve dhe zhvillimin personal të tyre, nisur nga gjetjet e analizës së mësipërme, rekomandohen autoritetet shtetërore shqiptare që:

Paraprakisht, nisur nga mangësitë e evidentuara për qëllim të këtij studimi, nevojiten përkthimet zyrtare që Shteti Shqiptar duhet tu bëjë rekomandimeve të Komiteteve të ndryshme që mbikqyrin zbatimin e Konventave Ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria. Gjithashtu, nevojitet përkthimi i plotë në gjuhën shqipe i Raporteve Periodike të këtyre Komiteteve që i adresohen Shqipërisë. Këto akte duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme nga të gjithë aktorët e interesuar publikë, shoqërorë, privatë.

Në adresim të Kuvendit të Shqipërisë shkojnë rekomandime për ndryshime legislative:

- Së pari, ndryshime të Kodit të Familjes (neni 51) përta i përket pamundësisë së bashkëshortëve që të mund të vendosin si mbiemër të përbashkët të familjes bashkësinë e mbiemrave të tyre. Ky realizim, jo vetëm do të bënte që Shqipëria të vendosej në linjë me standartet e e vendosura nga organet politike dhe gjyqsore të Këshillit të Europës, por do të krijonte kushte më të drejta për vendosje të barazisë midis bashkëshortëve në projektimin e identitetit të tyre tek fëmijët.
- Së dyti, ndryshime në Kodin e Familjes (neni 52) përta i përket parashikimit sipas të cilit në rast mosdakordësie për mbiemrin e fëmijëve midis bashkëshortëve me mbiemra të ndryshëm, vendoset automatikisht mbiemri i babait. Kjo dispozitë duhet ndryshuar duke hequr atribuimin ex lege të

⁷³ "Aborti selektiv me bazë gjinore në Shqipëri", Shoqata Together for Life, Korrik 2018. Sipas këtij studimi një nga arsyet kryesore përse familjet shqiptare preferojnë djalë, mbështetur në shumë të intervistuar, lidhet me trashëgiminë e mbiemrit dhe vazhdimësinë e fisit. Sipas të intervistuarve, prindërit duan patjetër djem sepse kjo është mënyra e vetme për të trashëguar e mbajtur gjallë mbiemrin e familjes dhe trashëgiminë e pasurive familjare.

Në po të njejtën linjë shiko edhe: UNFPA (2012), "Sex imbalances at birth in Albania"

https://www.unfpa.org/sites/default/files/resource-pdf/UNFPA_report_Albania2012.pdf

mbiemrit të babait dhe duke parashikuar zgjidhjen gjyqsore të çështjes. Ky realizim do të shkëpuste përfundimisht parashikimin ligjor nga ndikimi i mendësisë patriarkale e cila dukshëm vendos në pozita të pabarabarta prindërit për shkak gjinie. Njëkohësisht, ndryshimi do ta vendoste dispozitën në rend logjik me parashikimet e vetë Kodit të Familjes, duke respektuar barazinë midis prindërve, si dhe duke e vendosur zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshje në linjë me mënyrën më garantuese që kodi ka vendosur sidomos për garantimin i interesit më të lartë të fëmijës, që është zgjidhja gjyqsore.

- Së treti, ndryshimi i nenit 52 Kodi i Familjes të reflektohet edhe në dispozitat e kodit që merren me rregullimin e mbiemrit për fëmijët e lindur jashtë martese (neni 171 KF) dhe fëmijëve të birësuar (neni 260 KF), pasi paraqesin të njejtën situatë dhe në përmbajtje identike.
- Së katërti, në lidhje me konceptin e Kryefamiljarit në Ligjin Nr.10129, datë 11/05/2009, "Për gjendjen civile", i ndryshuar, të ndryshohen nenet 16 dhe 17 që parashikojnë të drejtën për deklarimin e vendbanimit, në mënyrë që të përshtaten me nenin 55 të Kodit të Familjes i cili parashikon dakordësinë midis bashkëshortëve për zgjedhjen e vendbanimit.
- Së pesti, Rikonsiderimin e konceptit të Kryefamiljarit nëpër ligje të ndryshme që e përdorin duke e eliminuar atë.

Në adresim të Këshillit të Ministrave shkojnë rekomandime për rikonsiderim aktesh nënligjore sidomos në lidhje me konceptin e Kryefamiljarit dhe vendosjen e atësisë në dokumentat e identifikimit në marrëdhënie me administratën.

- Së pari, rikonsiderim i konceptit të Kryefamiljarit duke e eliminuar atë, ose duke e njohur ekspresivisht në shumës dhe në vlerë të njejtë e të barabartë për të dy bashkëshortët, në të gjitha aktet nënligjore ku ky koncept figuron.
- Së dyti, heqja e këtij koncepti nga dokumenti i gjendjes civile që korespondon me certifikatën familjare ose njohja e atributit në mënyrë të barabartë për të dy bashkëshortët.
- Së treti, heqja e mënyrës së identifikimit të personit vetëm nëpërmjet atësisë në të gjithë aktet administrative të administratës publike.
- Së katërti, sidomos në aktet administrative të arsimit që lidhen direkt me fëmijët dhe i shoqërojnë ato përgjatë gjithë cikleve të arsimit (ku përfshihen certifikatat, dëftesat, diplomat), heqja e këtij elementi të bëhet në mënyrë të menjëhershme.
- Së pesti, vendosja e të dy komponentëve, mëmësi dhe atësi në të gjithë regjistrat shtetërorë ku përmbahen identitetet e personave.

- Së gjashti, vendosja e të dy elementëve identifikues, mëmësi dhe atësi, në kërkesat dhe aplikimet e ndryshme të personave në administratën publike, ose moskërkimi për asnjërin na komponentët. Shembull i mirë për përfshirjen e mëmësisë dhe atësisë evidentohen në depozitimin e padive nëpër Gjykata apo dhe formulari i aplikimit për ankesë pranë KMD-së; ndërsa për mospërfshirjen e asnjërit nga këto komponentë, merret si shembull formulari i ankesave pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Për Gjendjen Civile:

- Përpilimi i një formulari tip mbi marrëveshjen e prindërve për mbiemrin e fëmijëve ku të rezultojnë qartë dispozitat e KF dhe shprehja e vullnetit të tyre.
- Informimi i bashkëshortëve referuar parashikimeve që lidhen me të drejtën e tyre për mbiemrin e familjes, mbiemrin e tyre dhe mbiemrin e fëmijëve.
- Deri në ndryshimet e nevojshme ligjore dhe nënligjore, administrata e gjendjes civile duhet ta ndërpresë atribuimin automatik të Kryefamiljarit me komponentin mashkull në certifikatën e familjes. Ky atribuim është krejtësisht produkt i sjelljes së administratës dhe i ndikimit të mendësisë shoqërore në këtë sjellje dhe nuk ka asnjë bazë ligjore mbi gjininë e Kryefamiljarit.
- Njëkohësisht, deri në ndryshimet e nevojshme ligjore dhe nënligjore, administrata e gjendjes civile të rrisë informimin e bashkëshortëve gjatë kryerjes së aktit të martesës mbi konceptin e Kryefamiljarit dhe shprehjes së vullnetit të vetë bashkëshortëve në përcaktimin e certifikatës familjare.
- Kryerja e trajnimeve efektive të punonjësve të GJ.C sidomos në lidhje me implikimet gjinore të veprimeve të administratës të cilat nuk urdhërohen nga dispozitat e akteve normative.

Bibliografi

Akte Ndërkombëtare

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

<https://kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1524735491-DEKLARATA-UNIVERSALE-E-TE-DREJTAVE-TE-NJERIUT.pdf>

Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike

<https://hrrp.eu/alb/docs/CCPR-a.pdf>

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore <https://kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1524735715-Pakti-Drejtat-Ekonomike-Sociale-Kulturore.pdf>

Konventa e OKB-së për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave(CEDAW)

<https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/04/Konventa-mbi-eliminimin-e-Diskriminimit-ndaj-Grave.pdf>

Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve

<https://www.magjistratura.edu.al/media/users/4/konventa%20%20mbi%20te%20drejta%20e%20femijes.pdf>

Komenti i Përgjithshëm Nr.17 i Komisionit për të Drejtat e Njeriut

https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=INT%2FCCPR%2FGEC%2F6623&Lang=en

Rekomandimi i Përgjithshëm Nr.28 i Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Gruas

https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW%2FC%2FGC%2F28&Lang=en

Rekomandimi i Përgjithshëm Nr.21 i Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Gruas

https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=INT%2FCEDAW%2FGEC%2F4733&Lang=en

Rekomandimi i Përgjithshëm Nr.29 i Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Gruas

https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW%2FC%2FGC%2F29&Lang=en

Komenti i Përgjithshëm Nr.14 (2013) i Komitetit për të Drejtat e Fëmijës

https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRC%2FC%2FGC%2F14&Lang=en

Raporti i Tretë Periodik për Shqipërinë i Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Gruas, viti 2008.

<https://www.refworld.org/publisher,CEDAW,,ALB,4a646c080,0.html>

Raporti i Katërt Periodik për Shqipërinë i Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Gruas, viti 2014

<https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N14/664/83/PDF/N1466483.pdf?OpenElement>

Raporti i Pestë Periodik për Shqipërinë i Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Gruas, viti 2022

file:///C:/Users/ROBERT/Downloads/CEDAW_C_ALB_5-EN.pdf

Raporti i GREVIO-s për Shqipërinë miratuar në datë 12/10/2017. GREVIO/Inf(2017)13

<https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2020/07/Raporti-GREVIO.pdf>

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollat përkatëse të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut https://www.echr.coe.int/documents/convention_sqi.pdf

CASE OF ÜNAL TEKELİ v. TURKEY

<https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22fulltext%22:%5B%22C3%9Cnal%20Tekeli%20v.%20Turkey%22%5D,%22documentcollectionid%22:%5B%22GRANDCHAMBER%22,%22CHAMBER%22%5D,%22itemid%22:%5B%22001-67482%22%5D%7D>

European Court of Human Rights, León Madrid v. Spain

<https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22itemid%22:%5B%22002-13451%22%5D%7D>

European Court of Human Rights, AFFAIRE CUSAN ET FAZZO c. ITALIE

<https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-139896%22%5D%7D>

European Court of Human Rights CASE OF BURGHARTZ v. SWITZERLAND

<https://hudoc.echr.coe.int/#%7B%22fulltext%22:%5B%22BURGHARTZ%22%5D,%22documentcollectionid%22:%5B%22GRANDCHAMBER%22,%22CHAMBER%22%5D,%22itemid%22:%5B%22001-57865%22%5D%7D>

European Court of Human Rights AFFAIRE LOSONCI ROSE ET ROSE c. SUISSE

<https://hudoc.echr.coe.int/#%7B%22fulltext%22:%5B%22rose%22%5D,%22documentcollectionid%22:%5B%22GRANDCHAMBER%22,%22CHAMBER%22%5D,%22itemid%22:%5B%22001-101651%22%5D%7D>

Rezoluta (78) 37 “Mbi barazinë e bashkëshortëve në të drejtën civile”, e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës

<https://rm.coe.int/res-78-37e-on-the-equality-of-spouses-in-civil-law/1680a3b3f1>

Rekomandimi 1271 (1995) “Diskriminimi midis burrave dhe grave në zgjedhjen e mbiemrit dhe në kalimin e mbiemrave të prindërve tek fëmijët”, i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës

<https://pace.coe.int/en/files/15305/html>

Rekomandimi 1362 (1998) “Diskriminimi midis burrave dhe grave në zgjedhjen e mbiemrit dhe në kalimin e mbiemrave të prindërve tek fëmijët”, i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës.

<https://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=16599&lang=en>

Udhëzuesi mbi nenin 14 KEDNJ dhe Prot. Nr.12 i KEDNJ

https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_14_Art_1_Protocol_12_ENG.pdf

Raportin Shpjegues i Këshillit të Europës mbi Protokollin Nr.12 KEDNJ

<https://rm.coe.int/09000016800cce48>

Udhëzuesi mbi nenin 8 KEDNJ

https://www.echr.coe.int/documents/guide_art_8_eng.pdf

Udhëzuesi mbi nenin 12 KEDNJ

https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_12_ENG.pdf

Vendim Gjykata Kushtetuese Italiane 51/2006

<https://www.cortecostituzionale.it/actionSchedaPronuncia.do?anno=2006&numero=61>

Vendim Gjykata Kushtetuese Italiane 286/2016

https://www.cortecostituzionale.it/actionSchedaPronuncia.do?param_ecli=ECLI:IT:COST:2016:286

Vendim Gjykata Kushtetuese Italiane 131/2022

https://www.cortecostituzionale.it/actionSchedaPronuncia.do?param_ecli=ECLI:IT:COST:2022:131

Akte ligjore Sqiptare

Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar

<https://qbz.gov.al/preview/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd>

Ligji nr.9062, datë 8.5.2003, “Kodi i Familjes”, i ndryshuar.

<https://qbz.gov.al/preview/615c6db4-cfa8-4800-ba51-0444026e441d>

Ligj nr.7850, datë 29.7.1994 Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

<https://qbz.gov.al/preview/f010097e-d6c8-402f-8f10-d9b60af94744>

Ligji nr. 10 129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar,

<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2009/05/11/10129/c3ee244a-d790-4989-9a33-14ec398126c5;q=ligji%20gjendja%20civile>

Ligji nr.9198, datë 1.7.2004 “Për barazinë gjinore në shoqëri”

<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2004/07/01/9198/61e3da69-daa5-4b85-aafa-a45bf9740a22;q=barazine%20gjinore>

Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar

<https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/05/2.pdf>

Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2017/02/23/18-2017/a7b5c582-78fa-4109-beca-a0c7b48a2c8c;q=18%2F2017>

Ligji nr. 57/2019 “ Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”
<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2019/07/18/57/37004448-df0e-4768-9e88-35766f95ee4f>

Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social” <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2018/05/03/22/4c8cb879-1bf9-43ab-9c78-e00d82dfe642;q=ligj%20nr.%2022%2F2018>

Ligji nr.121/2016 “Për shërbimet sociale në Republikën e Shqipërisë”
<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2016/11/24/121-2016/858a0659-03b8-4ef6-982a-dc9340e41d4c;q=121%2F2016>

VKM Nr.400 datë 30/06/2021 Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030.
https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/WEB_Strategjia-Kombetare-AL.pdf

Literaturë

Aleks Luarasi “Marrëdhëniet Familjare” Botim i SHB Luarasi, Tiranë 2001

Arta Mandro “E drejta Familjare” SHB Emal, ShB Emal, Tiranë 2009

A.Mandro, A.Anastasi, E.Shkurti, A.Bozo “Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi”, SHB Dajti, Tiranë, 2011.

Mandro.A (2014), “Diskriminimi gjinor në çështjet familjare e martesore”.
<https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/Diskriminimi-gjinor-ne-ceshtjet-familjare-A.-Mandro.pdf>

Fabrizotti. A (2017), “Il diritto al cognome materno. Profili di diritto civile italiano, di diritto internazionale, dell’Unione europea, comparato ed internazionale private”
https://www.academia.edu/31880354/Il_diritto_al_cognome_materno_Profili_di_diritto_civile_italiano_di_diritto_internazionale_dell_Unione_europea_comparato_ed_internazionale_privato

Fabrizotti. A (2017), “La trasmissione del cognome materno secondo il diritto internazionale in materia di diritti umani”.
https://www.academia.edu/31880354/Il_diritto_al_cognome_materno_Profili_di_diritto_civile_italiano_di_diritto_internazionale_dell_Unione_europea_comparato_ed_internazionale_privato

Peleggi. R (2017), “Il cognome dei figli: Esperienze statali a confronto”.
https://www.academia.edu/31880354/Il_diritto_al_cognome_materno_Profili_di_diritto_civile_italiano_di_diritto_internazionale_dell_Unione_europea_comparato_ed_internazionale_privato

Tullio, L (2017), “The Child’s Surname in the Light of Italian Constitutional Legality”.
https://www.academia.edu/34575491/L_Tullio_The_Childs_Surname_in_the_Light_of_Italian_Constitutional_Legality

Mclanahan, S., Percheski, C., (2008) “Family Structure and the Reproduction of Inequality Annual Review of Sociology 34(1)”.
DOI:10.1146/annurev.soc.34.040507.134549

Callerstig A.-C. (2014) “Making equality work: Ambiguities, conflicts and change agents in the implementation of equality policies in public sector organisations”;

Linköping Studies in Art and Science, Vol. 607, Linköping University, Linköping (2014) Jayachandran, S (2015) The Roots of Gender Inequality in Developing Countries. Annual Review of Economics Vol. 7:63-88.

OECD, 2008. “Gender and sustainable development: maximizing the economic, social and environmental role of women”. In: “A Report to the United Nations Commission on Sustainable Development” (UNCSD)

Sex-selective abortions are discriminatory and should be banned
<https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/sex-selective-abortion-are-discriminatory-and-should-be-banned-1>

SHOQATA TOGETHER FOR LIFE (2018), “Aborti selektiv me bazë gjinore në Shqipëri”.
<https://www.togetherforlife.org.al/wp-content/uploads/2021/02/Aborti-selektiv-me-baze-gjinore-ne-Shqiperi.pdf>

UNFPA (2012), “Sex imbalances at birth in Albania”
https://www.unfpa.org/sites/default/files/resource-pdf/UNFPA_report_Albania2012.pdf

UNFPA Guidance Note on Prenatal Sex Selection
https://www.unfpa.org/sites/default/files/resource-pdf/guidenote_prenatal_sexselection.pdf

KMD, UN Women, 2018. “Barazia Gjinore dhe Diskriminimi në Organet e Emëruara të Pushtetit Vendor”.
<https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/05/Barazia-gjinore-dhe-diskriminimi-ne-organet-e-meruara-te-pushtetit-vendor.pdf>

“Të drejtat pronësore të grave në Shqipëri: analizë e standarteve ligjore dhe e zbatimit të tyre në praktikë.”, UN Women, Tiranë, 2016.
<https://albania.un.org/sites/default/files/2020-05/no.45-%20T%C3%8B%20DREJTAT%20PRON%C3%8BSORE%20T%C3%8B%20GRAVE%20N%C3%8B%20SHQIP%C3%8BRI.pdf>

Instituti i Statistikave (2021), Gratë dhe burrat në Shqipëri
<http://www.instat.gov.al/media/8696/grate-dhe-burra-ne-shqiperi-2021.pdf>



FORMULAR APLIKIMI

VLERËSIMI I PËRCAKTIMIT TË AFTËSISË SË KUFIZUAR

SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

MINISTRIA E SHËNDËTËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE



<p>Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni: Tel: +355 4 2376 178 E-mail: info@shendetesia.gov.al Web: www.shendetesia.gov.al</p>	<p>HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN</p>
<p>Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë.</p>	

SEKSIONI A: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKANTIN

1. Emri	<input type="text"/>	2. Mbiemri	<input type="text"/>
3. Emri i Babait	<input type="text"/>	4. NID <i>Nr. I identifikimit personal</i>	<input type="text"/>
5. Gjinia	<input type="checkbox"/> Mashkull <input type="checkbox"/> Femër	6. Datëlindja	<input type="text"/> <small>Data Muaji Viti</small>
7. Vendlindja	<input type="text"/>	8. Shtetësia	<input type="text"/>
9. Adresa	<input type="text"/>		
10. Qyteti	<input type="text"/>	11. Rrethi	<input type="text"/>
12. Kodi Postar	<input type="text"/>	13. Nr. Tel	<input type="text"/>
14. E-mail	<input type="text"/>	15. Nr. Sig Shëndetësor	<input type="text"/>

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

1. A keni aplikuar më parë për të marrë përfitime të aftësisë së kufizuar? Po Jo

2. A keni marrë përfitime të aftësisë së kufizuar më parë? Po Jo

3. Në cilën kategori bëni pjesë? *(zgjidh vetëm një mundësi, më të përshtatshmen për rastin tuaj)*

Mbi moshën 18 vjeç

I/e punësuar I/e vetëpunësuar I/e papunë Student

Shtëpiak/e Pensionist/e Qendër ditore Tjetër *(specifiko)*

Nën moshën 18 vjeç

Çerdhe Kopsht Nxënës Shtëpi

Tjetër *(specifiko)*

4. Historiku i punësimit *(nëse është i aplikueshëm)*

	nga	deri më
<input type="text"/>	<input type="text"/> <small>Data Muaji Viti</small>	<input type="text"/> <small>Data Muaji Viti</small>
<input type="text"/>	<input type="text"/> <small>Data Muaji Viti</small>	<input type="text"/> <small>Data Muaji Viti</small>
<input type="text"/>	<input type="text"/> <small>Data Muaji Viti</small>	<input type="text"/> <small>Data Muaji Viti</small>



FORMULAR APLIKIMI
VLERËSIMI MJEKËSOR PËR PËRCAKTIMIN E AFTËSISË SË KUFIZUAR
NGA MJEKU I PËRGJITHSHËM
 (FORMULAR PËR TË RRITUR)
 SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR
 MINISTRIA E SHENDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE



Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni: Tel: +355 4 2376 178 E-mail: info@shendetesia.gov.al Web: www.shendetesia.gov.al	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN
Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë.	

SEKSIONI A: INFORMACION SPECIFIK MBI PACIENTIN

1. Emri	<input type="text"/>	2. Mbiemri	<input type="text"/>
3. Emri i Babait	<input type="text"/>	4. NID <i>Nr. i identifikimit personal</i>	<input type="text"/>
5. Gjinia	<input type="checkbox"/> Mashkull <input type="checkbox"/> Femër	6. Datëlindja	<input type="text"/>
7. Vendlindja	<input type="text"/>	8. Shtetësia	<input type="text"/>
9. Adresa	<input type="text"/>		
10. Qyteti	<input type="text"/>	11. Rrethi	<input type="text"/>
12. Kodi Postar	<input type="text"/>	13. Nr. Tel	<input type="text"/>
14. E-mail	<input type="text"/>	15. Nr. Sig shëndetësor	<input type="text"/>

SEKSIONI A1: INFORMACION SPECIFIK MBI MJEKUN

1. Emri	<input type="text"/>	2. Mbiemri	<input type="text"/>
3. Numri i licencës	<input type="text"/>	4. Specialiteti	<input type="text"/>
5. Adresa	<input type="text"/>		
6. Qyteti	<input type="text"/>	7. Rrethi	<input type="text"/>
8. Kodi Postar	<input type="text"/>	9. Nr. Tel	<input type="text"/>
10. E-mail	<input type="text"/>		

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

Plotësoni fushat e mëposhtme në lidhje me aftësinë e kufizuar të pacientit tuaj. Informacioni do të përdoret si evidencë mjekësore mbi kërkesën për përfitimë për shkak të aftësisë së kufizuar dhe si rekomandim për vizitën tek mjeku specialist për këtë qëllim.

1. A është kjo hera e parë që ju e vizitoni pacientin për rekomandim të përfitimt të pagesës së aftësisë së kufizuar?
 Po Jo

2. Kohëzgjatja e trajtimit të pacientit

3. Numri i trajtimeve të pacientit në 12 muajt e fundit

4. Diagnoza kryesore e pacientit sipas emërimit në udhëzuesin Bio-Psiko-Social

5. Diagnoza të tjera (nëse ka)

Aneks 2

UDHËZIM Nr. 66, datë 4.2.2021

PËR MIRATIMIN E FORMATIT TË REGJISTRIT PËR REGJISTRIMIN E DEKRETIT PËR FITIMIN, RIFITIMIN DHE LËNIEN E SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 20, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”,

UDHËZOJ:

1. Dekretet për fitimin, rifitimin dhe lënien e shtetësisë shqiptare regjistrohen në një regjistër të veçantë për qëllime statistikore.

2. Regjistri administrohet nga struktura përkatëse që trajton çështjet e shtetësisë.

3. Për qëllim të njohjes dhe të vijimit të procedurave për regjistrim/çregjistrim pranë zyrave të gjendjes civile, në këtë regjistër ka akses edhe zyra përkatëse në Drejtorinë e Gjendjes Civile. Zyra përkatëse ka akses me këtë regjistër, duke pasur statusin e njohjes.

4. Regjistri duhet të përmbajë:

- numër dhe datë dekreti;

- **emër, atësi dhe mbiemër të personit;**

- për rastet e fitimit, shtetësinë e aplikuesit.

5. Të gjitha dekretet duhet të regjistrohen në regjistër nga struktura përgjegjëse, jo më vonë se 15 ditë pas ardhjes në Ministrinë e Brendshme.

6. Format i regjistrit përcaktohet në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Ngarkohet struktura përkatëse në fushën e shtetësisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM

SHTOJCA 1

REGJISTËR I DEKRETEVE PËR FITIMIN, RIFITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE					
Nr. dhe data e dekretit		Emër, atësi, mbiemër	Lloji i aplikimit	Shtetësia e aplikuesit	ZGJC e regjistrimit

REGJISTËR I DEKRETEVE PËR LËNIEN E SHTETËSISË SHQIPTARE				
Nr. dhe data e dekretit		Emër, atësi, Mbiemër	Lloji i aplikimit	ZGJC e çregjistrimit

Aneks 3

MARRËVESHJE DAKORDËSIE (TIP)

I ANËTARËVE TË FAMILJES BUJQËSORE

Sot më datë _____.____.2021, ne, të nënshkruarit, madhorë dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, si vijon:

1. _____, ID nr. personal _____
Emër Atësi Mbiemër

2. _____, ID nr. personal _____
Emër Atësi Mbiemër

3. _____, ID nr. personal _____
Emër Atësi Mbiemër

4. _____, ID nr. personal _____
Emër Atësi Mbiemër

AUTORIZOJMË

Anëtarin e familjes sonë bujqësore _____
(emër atësi mbiemër), që të kryejë aplikimin në e-Albania për familjen tonë bujqësore dhe të sigurojë çdo dokumentacion të nevojshëm për të përfituar nga skema e naftës për bujqësinë në lidhje me pasuritë e lartpërmendura. Gjithashtu, në rast miratimi të aplikimit, jemi dakord që ai të ndjekë procedurat për pajisjen me kartë dhe tërheqjen e sasisë përkatëse të naftës.

MARRËVESHJE DAKORDËSIE (TIP)

I BASHKËPRONARËVE NË CERTIFIKATËN E PRONËSISË

Sot më datë _____.____.2021, ne, të nënshkruarit, madhorë dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, si vijon:

1. _____, ID nr. personal _____
Emër Atësi Mbiemër

2. _____, ID nr. personal _____
Emër Atësi Mbiemër

3. _____, ID nr. personal _____
Emër Atësi Mbiemër

4. _____, ID nr. personal _____
Emër Atësi Mbiemër

Aneks 4

Nr. rendor	Emri/Atësia/Mbiemri	Përbërja familjare	Struktura e apartamentit që përfiton	Kushtet e strehimit (shkronja "a", e nenit 16)	Kushtet familjare (shkronja "b", e nenit 16)	Kushtet sociale (shkronja "c", e nenit 16)	Të ardhurat mujore neto të familjes	Punësimi	Vlera maksimale e kredisë që përfiton
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

Aneks 5

SHTOJCA 3 DEKLARIMI I GJENDJES GJYQËSORE

Të dhënat e vetëdeklaruesit;

Emër, atësi, mbiemër:

Datëlindja:

Vendlindja:

Dokumenti i identifikimit: (kopje bashkëlidhur formularit)

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam; i/e padënuar i/e dënuar

Emër, mbiemër:

Firmë:

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre.

Shënim. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, ndryshuar me ligjin nr. 48/2012 "Për mbrojtjen e të dhënave personale",,

Aneks 6

FORMULARI I KËRKESËS PËR RISHIKIMIN E TË DHËNAVE		
<p>Ju lutem shkruani qartë me shkronja të mëdha shtypi informacionin e kërkuar në hapësirën përkatëse. Plotësimi i këtij formulari është i nevojshëm për trajtimin e kërkesës suaj. Gjithashtu, bashkëlidhni me këtë kërkesë një kopje të dokumenteve shoqëruese të listuara më poshtë, të cilat janë të nevojshme për identifikimin tuaj nga Regjistri i Kredive për çdo kërkesë. Ju do të merrni nga ne brenda 15 ditësh një përgjigje në lidhje me depozitimin e kërkesës suaj për rishikimin e të dhënave. Nëse brenda dy javësh nuk merrni asnjë njoftim, ju lutem telefononi në numrat: 04 2419301; 04 2419302; 04 2419303.</p>		
Për:	Banka e Shqipërisë, Regjistri i Kredive, sheshi “Skënderbej”, nr.1, Tiranë, Shqipëri.	Vetëm për përdorim zyrtar të BSH
Nga:	<p>Emri, atësia, mbiemri i kërkuesit</p> <p>.....</p> <p>Nr.pasaporte/certifikatë lindjeje/letërnjoftimi/kartë identiteti</p> <p>.....</p> <p>Datëlindja:</p> <p>.....</p> <p>Adresa e vendbanimit:</p> <p>.....</p> <p>.....</p> <p>Nr. i telefonit:</p>	<p>Nr. reference:</p> <p>.....</p> <p>...</p> <p>Data e pranimit:</p> <p>.....</p> <p>...</p> <p>Punonjësi i autorizuar:</p> <p>.....</p> <p>.....</p> <p>Veprimi i kryer:</p> <p>.....</p> <p>..</p> <p>.....</p> <p>..</p> <p>.....</p> <p>..</p> <p>.....</p> <p>..</p>
<p>Dëshiroj të kërkoj rishikimin e kopjes së bashkëlidhur të raportit të kredimarrësit për subjektin e mëposhtëm (shënoni emrin e subjektit si në raportin e kredimarrësit):</p> <p>.....</p> <p><input type="checkbox"/> Jam subjekti i mësipërm</p> <p><input type="checkbox"/> Veproj në emër të subjektit dhe marrëdhënia ime me të është:</p> <p>.....</p> <p><input type="checkbox"/> Veproj në emër të personit juridik me:</p> <p>Emri i personit juridik _____ Numri i regjistrimit _____</p> <p>.....</p> <p>..... Data e regjistrimit _____</p> <p>Statusi ligjor (<i>Sh.a. Sh.p.k. etj.</i>) _____</p> <p>.....</p> <p>.....</p> <p>Ju lutem shënoni informacionin për të cilin kërkoni rishikim dhe bashkëlidhni dokumentet për të mbështetur kërkesën tuaj.</p>		
<p>Shpjegim i detajuar i kërkesës sime është si më poshtë:</p> <p>.....</p> <p>.....</p> <p>(Mund të bashkëlidhni faqe shtesë nëse hapësira nuk është e mjaftueshme/</p>		
<p>Nënshkrimi: _____ Data: _____</p>		

Shtojca nr.2



**FORMULAR APLIKIMI
PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË ARSIMIN BAZË
(Klasa e parë)**

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni: Tel: E-mail: Web:	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN
<i>Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë.</i>	

SEKSIONI A: INFORMACION MBI APLIKANTIN

1. Emri	<input type="text"/>	2. Mbiemri	<input type="text"/>
3. Emri i Babait	<input type="text"/>	4. NID <small>Nr. i identifikimit personal</small>	<input type="text"/>
5. Gjinia	<input type="checkbox"/> Mashkull <input type="checkbox"/> Femër	6. Datëlindja	<input type="text"/> <small>Data Muaji Viti</small>
7. Vendlindja	<input type="text"/>	8. Shtetësia	<input type="text"/>
9. Adresa	<input type="text"/>		
10. Qyteti	<input type="text"/>	11. Rrethi	<input type="text"/>
12. Kodi Postar	<input type="text"/>	13. E-mail	<input type="text"/>
14. Nr. Tel. Celular	<input type="text"/>	15. Nr. Tel. Fiks	<input type="text"/>

SEKSIONI C: DOKUMENTACIONI I PARAQITUR

- Vërtetim që femija ka ndjekur kopshtin ose klasën përgatitore (duhet dorëzuar dy javët e fundit të qershorit)
- Vërtetim vaksinimi nga qendra shëndetësore (duhet dorëzuar dy javë para fillimit të vitit shkollor)

KLAUZOLA DEKLARATIVE

